

1 E martë, 10 tetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e  
6 Gjykatës, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
8 çështja gjyqësore KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar  
9 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup  
10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Mirëmëngjesi. Së pari, Trupi Gjykses do të trajtojë një  
13 çështje para se të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit 03880.

14 Trupi Gjykses kupton që Mbrojtja e Thaçit kërkon që të  
15 zgjatet afati, numri i fjalëve me 9,000 fjalë për përgjigjen e  
16 përbashkët të Mbrojtjes ndaj mocionit të ZPS-së sipas  
17 rregullës 154.

18 Mbrojtja e Thaçit parashtron se kjo shtimi i numrit të  
19 fjalëve është i nevojshëm, duke pasur parasysh numrin e  
20 dëshmitarëve në fjalë, ndërlikimin e çështjeve që janë ngritur  
21 në të, vëllimin e materialeve që janë dorëzuar dhe nevojën për  
22 t'u trajtuar si deklaratat e propozuara dhe provat materiale  
23 që janë paraqitur në këtë parashtrim të protokolluar.

24 Trupi Gjykses kupton, me sa ka kuptuar Trupi Gjykses,  
25 ZPS-ja nuk ka kundërshtim për kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit.

1 Ndonjë pjesëmarrës tjetër ka diçka për të shtuar? Atëherë  
2 shohim që nuk ka kundërshtime.

3 Bazuar në parashtrimin e palëve, Trupi Gjykses miraton  
4 kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për shtimin e numrit të fjalëve  
5 me 9,000 fjalë për përgjigjen e përbashkët të Mbrojtjes ndaj  
6 mocionit të ZPS-së sipas rregullës 154. Përkatësisht është  
7 parashtrimi i protokolluar 01830.

8 Trupi Gjykses kërkon që të mos bëhet një citim fjalë për  
9 fjalë i rregullave në përgjigjen e përbashkët të Mbrojtjes dhe  
10 parashtrimet të jenë të përmbledhura, të fokusuara sa u takon  
11 çështjeve që kontestohen mes palëve.

12 Tani mund të vazhdojmë me pyetjet nga ana e Mbrojtjes së  
13 Thaçit.

14 Sekretare e Gjykatës, ju lutemi sillni dëshmitarin.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Më jepni një çast ju lutem.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
17 prisni.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo ka lidhje me materialet që janë  
19 nxjerrë dje, që i morëm. Sa i takon nxjerrjes së materialeve  
20 sipas rregullës 103 që morëm dje për dëshmitarin e radhës.  
21 Tani kjo ka të bëjë me detyrimin e ZPS-së për të nxjerrë  
22 materialin 103, jo vetëm për këtë dëshmitar, por edhe për  
23 dëshmitarët e tjerë.

24 Mendoj, bazuar në materialet që na janë nxjerrë dje, edhe  
25 gjatë fundjavës nga ZPS-ja, është e qartë që janë materiale

1 sipas rregullës 103 dhe ka kaluar shumë kohë dhe këto  
2 materiale nuk ishin nxjerrë dhe filluan të nxirreshin vetëm  
3 dhe edhe gjatë fundjavës. Kjo më bën pak, kam pikëpyetje tani  
4 për këtë. Duke parë parasysh kontaktet e shumta që ka pasur  
5 dëshmitari që është në bankën tonë të dëshmitarëve me ZPS-në.  
6 E marrë së bashku kjo me pretendimet që kanë ngritur për z.  
7 Thaçi që është përgjuar me z. Demaçin, që del për herë të  
8 parë, dhe kjo del për herë të parë më 6 tetor 2023, 5 vjet pas  
9 faktit - më falni, 25 vjet pas faktit.

10 Unë nuk e dimë çfarë ka ZPS-ja në zotërim dhe as nuk e  
11 kemi ditur çfarë materialesh sipas rregullës 103 ka pasur ZPS-  
12 ja për dëshmitarët e radhës dhe këtë nuk e kemi ditur deri  
13 dhe, edhe morëm vesh diçka gjatë fundjavës.

14 Tani kjo është shumë e rëndësishme për ne, sa i takon  
15 këtij dëshmitari, se ka treguar disa versione të historisë.  
16 Kështu që kërkoj të më udhëzoni si të vazhdojmë ne tani, duke  
17 marrë parasysh që detyrimi i rregullës 103, të paktën mënyra  
18 se si e kuptojmë ne, unë po përpiqem të jem sa më i sjellshëm,  
19 nuk është aq e qartë, nuk është shumë e qartë, nuk është shumë  
20 e qartë. Dhe unë kam nevojë ta diskutoj këtë me Trupin  
21 Gjykues, sepse dhe nuk e dija këtë gjë, por ama tani dolën  
22 gjëra të reja dhe janë tashmë në vëmendjen tonë dhe dua t'ju  
23 them që kjo ndikon dhe te ky dëshmitar, duke marrë parasysh  
24 disa nga zbulimet, madje alarmuese, do thoja, që ka zbuluar  
25 gjatë bisedave me ZPS-së para disa ditësh.

1 Kështu që mendoj si fillim duhet të rishikojë ZPS-ja  
2 menjëherë materialet lidhur me çdo material që lidhet me  
3 rregullën 103 para se ne të vazhdojmë me pyetjet tona.

4 Tani pse duhen diskutuar këto në *ex parte* apo me Trupin  
5 Gjykues për rishikim. Sigurisht që ne duam, prandaj, po e  
6 themi që Trupi Gjykues që *in camera ex parte* të bëhet një  
7 shqyrtim i materialeve për të parë nëse janë materiale që i  
8 përkasin rregullës 103.

9 Ama, ajo që po them unë, i nderuar Gjykatës, është që ne  
10 nuk e dimë tani; ne nuk jemi të qartë. Për ne materialet që  
11 kanë dalë tani janë materiale të rregullës 103 për dëshmitarin  
12 e radhës. Por, unë po ju them që ka lidhje edhe me këtë  
13 dëshmitar se kam pikëpyetje serioze lidhur me standardet që ka  
14 përdorur Prokuroria sa i takon materialeve të rregullës 103.

15 Me sa di unë edhe kolegët e mi kanë disa pikëpyetje, por  
16 unë po shpreh parashtrimin për llogari të Mbrojtjes së Thaçit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
18 çaktivizuar]

19 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit. Është hera e dytë në  
20 dy ditë që ZPS-ja nuk ka pasur komunikim *inter partes* lidhur  
21 me një çështje si kjo, siç e ka kërkuar, e keni bërë ju të  
22 qartë me rregullën për zhvillimin e procesit gjyqësor. Ju  
23 konkretisht në paragrafin 128, me mënyrën si duhet të  
24 zhvillohen këto bisedimin.

25 Sidoqoftë, Mbrojtja po flet për dëshmitarin që kemi në

1 bankën e dëshmitarëve, dhe për një dëshmitar që do të vijë në  
2 të ardhmen. Sa i takon dëshmitarit që kemi aktualisht, çështja  
3 që ngre avokati lidhur me dëshminë që ka dhënë ai, për  
4 përgjimin, përgjimin me Demaçin, mes Demaçit dhe Thaçit, kjo  
5 ka qenë një dëshmi që e kemi nxjerrë më përpara. Kështu që nuk  
6 ka asgjë këtu, nuk ka informacion sipas rregullës 103. Ishte  
7 një informacion që e morëm për herë të parë gjatë seancës  
8 përgatitore dhe këtë informacion e ndamë menjëherë me  
9 avokatët. Kështu që çdo gjë tjetër përtej kësaj është thjesht  
10 spekulative.

11 Me kënaqësi dua të trajtoj edhe aspektet e tjera sa i  
12 takon dëshmitarit të radhës. Materialet që kemi nxjerrë lidhur  
13 me dëshmitarët e tjerë besoj se kemi përmbushur tërësisht  
14 detyrimet tona sipas rregullës 103 në këtë drejtim. Kemi  
15 nxjerrë dhe materiale shtesë, bazuar në seancat përgatitore që  
16 kemi pasur rishtazi. Rrjedhimisht kjo ndryshoi pak mënyrën si  
17 e kishim kuptuar ne detyrimet sipas rregullës 103. Edhe kemi  
18 marrë 6 ose 7 kërkesa nga ekipe të ndryshme të Mbrojtjes për  
19 të marrë materiale shtesë muajt e shkuar. Jemi përpjekur t'i  
20 plotësisht tërësisht këto kërkesa dhe besojmë se i kemi  
21 respektuar tërësisht kërkesat e tyre. Prapë, po ju themi që  
22 nuk ka pasur asnjë problematikë sa i takon rregullës 103. Të  
23 gjitha pretendimet që u ngritën janë thjesht spekulative.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Arsyeja pse nuk u ngrita më herët  
25 është se unë nuk kisha gjë për të thënë lidhur me ndikimin që

1 ka kjo te dëshmitari i radhës. Unë parashtroj se duhen thënë  
2 shumë gjëra, ka shumë për t'u trajtuar lidhur me dëshmitarin  
3 që do të vijë dhe nuk është këtu momenti për Prokurorinë të  
4 kundërpërgjigjet dhe për të thënë çfarë ka bërë apo çfarë nuk  
5 ka bërë në të shkuarën; në ka vepruar mirë apo ka vepruar keq.  
6 Kur të vijë dëshmitari i që është për t'u diskutuar, mendoj që  
7 duhet ta diskutojmë më tej.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Për t'ju përgjigjur Prokurorisë.

9 Të nderuar Gjykatës, ne po përpigemi të bëjmë të  
10 pamundurën sapa na vjen informacioni. E kuptoj unë që nevoja  
11 dhe dëshira e Trupit Gjykues është që të kemi komunikim *inter*  
12 *partes*, por në këtë situatë ne nuk kemi kohë.

13 Ne marrim informacion, në fundjavë morëm pak, pastaj  
14 morëm më shumë dje dhe ishte alarmuese, ishte tronditëse,  
15 sepse qartazi është material i rregullës 103 që unë besoj se  
16 ju si Trup Gjykues e keni parë. Kjo është problematika dhe  
17 kësaj i mëshoj unë edhe për këtë u ngrita unë në këmbë, sa i  
18 takon cenimit të rregullës 103 për këtë dëshmitar.

19 Është nxjerrë material në shënimin përgatitor 2, por tani  
20 çështja shtrohet, çfarë tjetër ka për këtë dëshmitar që ne nuk  
21 e dimë akoma. Që ne ende nuk e kemi marrë si informacion.  
22 Thjesht nuk e dimë.

23 A ka spekulim këtu? Sigurisht që ka spekulim. Unë nuk  
24 mund të çohem në këmbë e të them, që unë e di me siguri se unë  
25 nuk i di gjërat me siguri. Prandaj unë them që ta zgjidhim

1 këtë situatë dhe Prokuroria duhet t'i nxjerrë *ex parte in*  
2 *camera*, të gjitha materialet që ka lidhur me këtë dëshmitar  
3 për të përcaktuar nëse materiali është material i rregullës  
4 103. Mund të mos jetë, por nuk e dimi dhe unë s'mund të jem  
5 duke përfaqësuar siç duhet klientin tim nëse nuk e ngre unë  
6 këtë çështje me këtë dëshmitar. Sepse disa nga gjërat  
7 alarmuese që na janë thënë dje dhe gjatë fundjavës edhe lidhur  
8 me dëshmitarin e radhës janë shqetësuese.

9 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
11 çaktivizuar]

12 Kërkesa juaj për të hulumtuar në bazën e të dhënave të  
13 Prokurorisë është detyrim i Prokurorisë dhe ata thonë që do të  
14 hulumtojmë ne, ne nuk do të bëjmë asgjë më tej. Ne thjesht do  
15 të vazhdojmë sot me këtë dëshmitar, kaq.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Të më kuptoni, i nderuar Gjykatës.  
17 Ta sqaroj atë që po them. Unë nuk po them të hulumtoni ju.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dhe ne  
19 kemi një kufi në punën tonë. Ne ju, ne pretendojmë që dhe ju  
20 dhe Prokuroria të na thoni të vërtetën. Nëse ata më vonë  
21 zbulojnë diçka a nuk do të donit ju ta merrnit vesh? Sigurisht  
22 që doni ta merrni vesh kur ta zbulojnë.

23 Fakti që ju kanë njoftuar dy ditë para dëshmitarit do të  
24 thotë që domethënë nuk është, ata nuk janë përpjekur ta  
25 shtyjnë atë informacionin. Thjesht atëherë e kanë marrë.

1           Z. KEHOE: [Përkthim] Unë po ju të dimë çdo kontakt që  
2 kanë pasur me këtë dëshmitar t'ia japim Trupit Gjykses. Trupi  
3 Gjykses të shohë kontaktin që kanë pasur këta me këtë  
4 dëshmitar. Informacioni për dëshmitarin e radhës nuk është  
5 informacion i ri.

6           Informacioni rregullës 103 që ne morëm dje lidhur me  
7 dëshmitarin e radhës nuk është informacion i rregullës 103 që  
8 doli papritmas para ca ditësh. Është një informacion që ka  
9 qenë në zotërimin e Prokurorisë prej kohësh. Prandaj, unë ngre  
10 pikëpyetjen pse.

11          Z. BOYLE: [Përkthim] Besoj se Gjykatësi ka marrë vendim  
12 në lidhje me këtë çështje.

13          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dikush në  
14 zyrën tuaj mund të marrë thjesht telefonin dhe t'i marrë në  
15 telefon. Po kjo është *inter partes*, ky është komunikimi *inter*  
16 *partes*. Dikush nga ekipi juaj le t'i marri në telefon dhe t'i  
17 pyesë. Pse s'po ndodh kjo, s'po e kuptoj. Me sa di unë, ju i  
18 keni trajtuar më parë në këtë formë gjëra të tilla.

19          Z. KEHOE: [Përkthim] Po mund ta bëjmë dhe këtë.

20          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë  
21 bëjeni.

22          Z. KEHOE: [Përkthim] Problemi është kur merr këtë  
23 informacion në 23.00, për dëshmitarin e radhës, por ama unë po  
24 ju flas për dëshmitarin në fjalë. Nuk e dimë a kemi  
25 informacion shtesë, por unë s'po ju thoja ju të hulumtoni ju



1 dosjet e ZPS-së.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kam asgjë  
3 për të thënë më shumë. Do vazhdojmë me pyetjet; sillni  
4 dëshmitarin në sallën e gjyqit.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
7 Dëshmitar.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë  
10 me kundërpjetet nga ekipet e Mbrojtjes. Ju lutemi,  
11 përgjigjuni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë se  
12 nuk e kuptoni një pyetje lirisht kërkoni që të përsëritet ose  
13 thjesht thoni që nuk e kuptoni pyetjet dhe ata do të përpigjen  
14 t'ua sqarojnë. Gjithashtu, mos harroni të na thoni ku e bazoni  
15 njohurinë tuaj lidhur me faktet dhe rrethanat për të cilat do  
16 të jepni përgjigje. Ju kujtoj se jeni ende nën betim për të  
17 thënë të vërtetën sikurse e thatë vetë në deklaratën solemne.  
18 Mos harroni të flisni para mikrofonit dhe prisni pesë sekonda  
19 përpara se të përgjigjeni në mënyrë që të keni mundësi edhe  
20 përkthyesit t'ju ndjekin. Në rast se keni nevojë për pushime  
21 na njoftoni dhe do bëjmë të pamundurën për t'jua plotësuar  
22 këtë kërkesë.

23 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e z. Kehoe. Z. Kehoe,  
24 keni fjalën.

25 DËSHMITARI: 03880 [Vijon]

1 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

2 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe: [Vazhdim]

3 Z. KEHOE: [Përkthim]:

4 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar. Dje po flisnim për ndalimin e  
5 UÇK-së. Më 29 tetor, më falni, më 18 tetor.

6 Ju na thatë dje që të kuptojmë kontekstin, thatë që nuk  
7 kishit shenja të shtypit dhe as nuk kishit autorizim nga Adem  
8 Demaçi për të udhëtuar në zonën e UÇK-së, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Ama ju e dinit që z. Demaçi jepte autorizime, lëshonte  
11 autorizimet për përfaqësuesit e mediave në mënyrë që t'u jepte  
12 leje të udhëtonin në zonat e UÇK-së, a nuk e dini këtë?

13 PË. Jo.

14 PY. Pra, në dëshminë tuaj, ju po thoni që nuk e kishit idenë,  
15 më 18 tetor apo para kësaj date që Z. Demaçi jepte leje apo  
16 autorizime për pjesëtarët e shtypit që të udhëtonin në zonat e  
17 UÇK-së, kështu? Autorizim me shkrim e kemi fjalën.

18 PË. E drejtë është, po, nuk e dija.

19 PY. Ju jeni një person që keni takuar përfaqësues të tjerë të  
20 shtypit në Qendrën për Shtypin në Serbi dhe keni diskutuar se  
21 çfarë ndodhte në Kosovë me anëtarët e tjerë të shtypit apo jo?

22 PË. Po, e vërtetë është.

23 PY. Pra, në asnjë moment ju nuk e mësuat, gjatë këtyre  
24 bisedave, që z. Demaçi lëshonte autorizime për pjesëtarët e  
25 shtypit që do të udhëtonin në zonën e UÇK-së, këtë po thoni në

1 dëshminë tuaj?

2 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj. Është bërë pyetja dhe  
3 ka marrë përgjigje.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
5 çaktivizuar]

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo. E kam tani fjalën për kontaktin  
7 që ka pasur me anëtarët e medias.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëni edhe një  
9 herë pyetjen.

10 Z. KEHOE: [Përkthim]

11 PY. Bazuar në kontaktet që ke pasur me pjesëtarë të tjerë të  
12 shtypit, ju po thoni, para Trupit Gjykses, që ju asnjëherë nuk  
13 e mësuat që Adem Demaçi jepte leje me shkrim për të udhëtuar  
14 në zonat e UÇK-së? Këtë po thoni me dëshminë tuaj?

15 PË. Këtë po të them. Nuk e kam ditur.

16 PY. Pra, ju thoni që u ballafaquat me një grup të UÇK-së dhe  
17 z. Dobricic i kaloi përmes, kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe dje, në transkriptin e djeshëm është reflektuar kjo,  
20 në faqen 92, rreshti 17. Pra, ju thatë, që ecët rreth 50,  
21 vazhduat dhe 50 dhe 100 metra derisa u kthyet pastaj. Por kjo  
22 nuk është e saktë apo jo?

23 PË. Unë po them që është e saktë. 50 ose 100 metra, pastaj u  
24 kthyet pas. Kishte persona në anë të rrugës, rrugës dhe ata na  
25 ndaluan.

1 PY. Në faqen 91 të transkriptit të djeshëm, në rreshtat 15  
2 deri në 18 ju e keni pranuar që e keni vazhduar kaluat mes  
3 përmes pikën e UÇK-së dhe 500 metra thuhet këtu, dhe më pas u  
4 kthyet në pikën e kontrollit. Dhe ju u përgjigjët, po, kështu,  
5 kështu. Në deklaratën e 2012, që besoj se është prova  
6 materiale, pra, është prova materiale 490. Këtu vëreni, thoni:

7 "Pas 50 metrash ne kuptuat që kishte një pikë tjetër  
8 kontrolli të UÇK-së dhe se kishim hyrë në territor të  
9 kontrolluar prej ZPS-së".

10 Ju thatë, pra, në 2012, keni thënë 500 metra, edhe ZPS-së  
11 i keni thënë që po ashtu ka qenë 500 metra. Keni vazhduar dhe  
12 500 metra.

13 PË. Po 100, 150, 200, ç'rëndësi ka. Pra, vazhduam edhe disa  
14 qindra metra. Thuaj sa të duash. Pastaj u kthyem pas.

15 PY. Pas, pra, ju vazhduat edhe gjysmë kilometri dhe në ato  
16 momente patë një pikë tjetër kontrolli të UÇK-së apo jo?

17 PË. Jo. Nuk pamë asnjë pikë tjetër kontrolli. Jua shpjegova.  
18 Por ne thjeshtë kuptuam që kishim, që po avanconim më tej në  
19 territor të UÇK-së. Pra, që ishte në kontrollin e tyre, me  
20 fjalë të tjera. Dhe ne kthyem automjetin pas dhe në serbisht  
21 dhe thamë "Zot na -- Zoti na ndihtë". Kështu themi në  
22 serbisht. Po fatmirësisht ne në fund na liruan.

23 PË. Atëherë do t'ju kujtoj çfarë i keni thënë ZPS-së me 6  
24 tetor. Në faqen 2 ju keni thënë kështu. Pra, ju keni sqaruar  
25 dhe keni thënë, nuk kanë qenë 8 ose 10 anëtarë të UÇK-së në

1 pikën e kontrollit, por keni thënë se ishin rreth 15 ose 20  
2 persona gjithsej. Por 8 ose 10 ishin nga një anë e rrugës dhe  
3 pjesa tjetër e anëtarëve të UÇK-së ishin diku në kodër.

4 A ju kujtohet që ia keni thënë këtë ZPS-së?

5 PË. Po, kështu e kam thënë.

6 PY. Atëherë unë po ju sugjeroj këtë: Keni kaluar mes përmes  
7 pikës së kontrollit të UÇK-së; nuk kishit shenja identifikimi;  
8 nuk kishit leje nga Demaçi; ju i anashkaluat pjesëtarët e UÇK-  
9 së dhe kur vazhduat rrugën patë që në një kodër kishte anëtarë  
10 të tjerë të UÇK-së dhe në ato momente ju vendosët të  
11 ktheheshit, sepse ju dhe z. Dobricic ju kapën, s'kishit më nga  
12 të shkonit; nuk kishit më ku të shkonit apo jo?

13 PË. Jo. Së pari, ne po zbrisnim kodrën, nuk po ngjiteshim në  
14 kodër, që ta sqaroj. Ne pamë një fshat përpara nesh; ne  
15 vazhduam rreth 250 metra, sa të duash thuaj, dhe aty vendosëm  
16 të ktheheshim. Këta persona, një grup, pra, ishte në anë të  
17 rrugës dhe mbi rrugë, në të djathtë, në kodrën që përmenda unë  
18 ishin rreth 4 apo 5 anëtarë të tjerë të UÇK-së.

19 PY. Po. Kishte pjesëtarë të tjerë të UÇK-së sipër, mbi kodrën  
20 drejt të cilës po vozisnit ju apo jo?

21 PË. Kur u kthyem i pamë në të djathtë.

22 PY. Pra, ju po udhëtoni mes dy grupeve të UÇK-së apo jo?

23 PË. Jo, pra.

24 PY. Zotëri, ta lexojmë dhe një herë atë që ke thënë.

25 PË. Ta lexojmë.

1 PY. Po kështu i ke thënë Prokurorisë.

2 PË. Po.

3 PY. Ju keni thënë, në rrugën ku na ndaluan kishte pjesëtarë  
4 të tjerë të UÇK-së në një vend diku lart në kodër. Pra, ju  
5 kapën; ju ngecët, ngecët mes dy grupeve të UÇK-së, grupeve,  
6 grupit të UÇK-së që ju e anashkaluat dhe grupit tjetër që  
7 ishte diku në kodër. Pra, ju ngecët, ju kapën.

8 PË. Jo, jo, jo. Ka një keqkuptim shumë të madh këtu. A më  
9 lejoni t'ju sqaroj edhe një herë.

10 Ne e kaluam grupin e parë të UÇK-së që ishin në djathtë  
11 të rrugës. Ne vazhduam, zbrisnim kodrën dhe pamë një fshat.  
12 Pas disa qindra metrash ne u kthyem dhe kaluam të njëjtin  
13 grup. I njëjti grup, tani në kthim ishte në të majtë, por ku u  
14 kthyem pamë që kishte dhe disa pjesëtarë të tjerë të UÇK-së në  
15 të djathtë të rrugës, diku pak më lart në kodër. Po flasim për  
16 të njëjtin grup.

17 PY. Pra, ju kaloni grupin e parë, shihni një grup tjetër në  
18 kodër dhe pikërisht në këtë momente ju vendosët të ktheheni  
19 pas.

20 PË. Jo. Jo, s'po e kupton çfarë po përpiqem të të shpjegoj.  
21 Vazhdon të këmbëngulësh që ka qenë grup tjetër. Unë po të  
22 tregoj çfarë ka ndodhur. Ishte i njëjti grup. Po flas për të  
23 njëjtin grup. Ne kaluam grupin e parë, u kthyem. Dhe kur u  
24 kthyem gjatë rrugës në kthim pamë të njëjtin grup që pamë  
25 herën e parë, por u kthyem pamë edhe një grupi tjetër në të

1 njëjtin vend, por diku pak më lart në kodër.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe, e  
3 ka shpjeguar disa herë. Trupi Gjykses e kupton, por ju me sa  
4 duket s'po e kuptoni. Disa herë e ka përsëritur të njëjtën  
5 gjë.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, problemi është që ndryshon me  
7 versionin që i ka thënë ZPS-së.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është  
9 tjetër çështje. Ama ju po i thoni kjo është e vërtetë; ai po  
10 ju thotë që s'është e vërtetë dhe ai po ju thotë të vërtetën  
11 siç e kupton ai.

12 Z. BOYLE: [Përkthim] Më lejoni, më lejoni të ndërhy,  
13 sepse është bërë një shtrembërim i asaj që ai i ka thënë ZPS-  
14 së. Nuk ka asnjë kontradiktë mes versionit që po thotë tani  
15 dhe atë që i ka thënë ZPS-së.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Këto trajtoji kur të kesh pyetjet  
17 shtesë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po thotë  
19 që ka parë grup të dytë. Po thotë që pashë të njëjtin grup dy  
20 herë.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Po jo pra. ZPS-së i ka thënë, pashë  
22 pjesëtarë të tjerë shtesë, apo të tjerë të UÇK-së diku lart në  
23 kodër.

24 PË. Po e saktë është kjo, por ishte në të njëjtin vend. Po  
25 diku lart në kodër. S'i pamë të gjithë. Ne thjesht kaluam aty;

1 pamë një grup në të djathtë dhe pasi kaluam 150 metra, 200  
2 metra, 500 metra po deshe ti, ne u kthyem dhe kur u kthyem i  
3 njëjti grup që kishte qenë në të djathtë ishte tashmë në të  
4 majtë dhe u afruan në rrugë, ishin diku në rrugë dhe në të  
5 majtë pamë një grup tjetër të UÇK-së. Pra, ishte i njëjti grup  
6 që ishte ndarë në dy anë të rrugës, por unë po ju them që  
7 ishte i njëjti vend. Ishin disa në të djathtë të rrugës dhe  
8 disa të tjerë në të majtë, diku në kodër.  
9 PY. Më falni se ju ndërpreva.

10 Z. Radosevic, ju kaluat grupin e parë të UÇK-së. Vazhdoni  
11 të vozisni automjetin, por ama u kthyet. A nuk pajtoheni me  
12 mua që sjellja juaj në ato momente ishte e dyshimtë? Ishit në  
13 një zonë luftimesh. A nuk mendoni që sjellja juaj ishte e  
14 dyshimtë?

15 PË. Nëse do ta shihja situatën tani qoftë unë apo dhe ju, apo  
16 kushdo tjetër, është e vërtetë që ne nuk duhet të ishim atje.  
17 Në qoftë se ne ishim të dyshimtë apo jo ne thjesht po  
18 vozisnim. Mbase mund të ishim parë me dyshim, mbase nuk duhet  
19 të ishim fare atje. Keni të drejtë këtu. Megjithatë, ne  
20 thjesht po bënim punën tonë. Për ta bërë të qartë, vendi ishte  
21 i lirë, të gjithë mund të shkonin gjithandej dhe kishte hyrë  
22 në fuqi marrëveshja ndërmjet Milosevic dhe Holbrooke që  
23 garantonte kalim të lirë. Kështu që, nuk di t'ju them. Nuk e  
24 di se çfarë kishte dyshim lidhur me këtë. Mund ta shikosh nga  
25 të dyja anët ashtu siç e shikoni ju dhe ashtu siç e shpjegova



1 unë.

2 PY. Ju lutem, tregoni zotëri që ju dhe z. Dobricic që u  
3 ndaluat, ju po mblidhnit informacion për të shkruar artikuj  
4 dhe z. Dobricic mendohej që të ishte gazetar që bënte  
5 fotografi, a është e vërtetë kjo? Domethënë që merrte  
6 fotografi. Kështu ishte apo mund të na e sqaroni pak ndryshe?

7 PË. Për mua, z. Dobricic ishte gazetar që bënte fotografi.  
8 Mua më dërguan nga Tanjug-u si gazet dhe është e vërtetë, jua  
9 thashë. Ne kemi qemë aty dhe po e them përsëri që kryesisht z.  
10 Dobricic dëshironte që të bënte disa fotografi të tjera të një  
11 automjeti të policisë për të cilën kishim marrë informacion që  
12 kjo makina ishte diku aty dhe që kishte plumba në pjesën e  
13 jashtme. Ai dëshironte të bënte fotografi të këtij automjeti.

14 Po e përsëris edhe një herë që ne u nisëm. Misioni i  
15 OSBE-së mendohej që të mbërrinte dhe pastaj shkuam pak më  
16 thellë në atë zonë sepse Misioni ishte me vonesë dhe thjesht  
17 dëshironim që të fitonim kohë, të mos prisnim dhe dy orë të  
18 tjera derisa të vinte Misioni i OSBE-së.

19 PY. Z. Radosevic, a mund të na thoni një artikull që keni  
20 shkruar për Tanjug-un me fotografi të bëra nga z. Dobricic dhe  
21 që i keni dërguar pasi janë bërë këtë fotografitë gjatë këtij  
22 udhëtimit së bashku me z. Dobricic?

23 A mund të na tregoni, qoftë edhe një artikull të vetëm,  
24 ku ju keni shkruar artikullin dhe ku z. Dobricic ka bërë  
25 fotografitë?

1 PË. Mund të ketë. Ne kemi qenë të pranishëm në shumë  
2 konferenca për shtyp. Dhe kemi punuar, kemi bashkëpunuar  
3 shpesh me njëri-tjetrin. Unë kam shkruar artikuj; ai ka bërë  
4 fotografitë; unë ua kam dërguar artikujt e plotë personave të  
5 cilët ishin përgjegjës dhe personave që ishin përgjegjës për  
6 fotografitë. Pa diskutim që ka artikuj. Në qoftë se ti më  
7 kërkon mua tani që të them një artikull nuk mund të ta them.  
8 Për shembull, mund të ketë pasur një konferencë për shtyp të  
9 përqendruar te bujqësia apo një konferencë për shtyp e dhënë  
10 nga z. Baki Andjelkovic, domethënë mund të ketë pasur artikuj  
11 të ndryshëm. Është e pamundur për mua që të them tani pas 25  
12 viteve se çfarë artikujsh kam shkruar. Në qoftë se artikujt,  
13 për shembull, mund të kenë pasur të bëjnë me regjistrimin e  
14 studentëve në universitet atë vit, për shembull, kam shkruar  
15 me qindra artikuj. Mbase mund të më kërkonin që t'ju them  
16 ndonjë artikuj që kam shkruar një javë më përpara ose një muaj  
17 për përpara, por t'ju them tani pas 25 viteve se çfarë  
18 artikujsh kam shkruar dhe artikuj që lidhen me fotografitë e  
19 bëra nga z. Dobricic është pak e pamundur. Kanë kaluar 25 vite  
20 që prej asaj kohe. Unë jam gazetar agjencie. Kjo është puna  
21 ime e përditshme. Ndonjëherë shkruaj katër apo pesë artikuj të  
22 ndryshëm për tema të ndryshme.

23 PË. Siç na e thatë zotëri, ju nuk mund të përmendni qoftë  
24 edhe një artikull të vetëm që keni shkruar pas udhëtimeve me  
25 z. Dobricic. Pra, në këtë vizitën që keni bërë nga viti '96

1 deri në '98 [sipas përkthimit] dhe në punët e përbashkëta që  
2 keni bërë me z. Dobricic ju po thoni që nuk jeni në gjendje të  
3 përmendni qoftë edhe një artikull të vetëm. Këtë po thoni?  
4 PË. Së pari, ai nuk ka qenë aty që prej '96 apo '97. Jua  
5 thashë edhe dje që ai ka mbërritur në '98 dhe ka qëndruar për  
6 disa muaj dhe ne u kapëm. Kaq ishte. Më vonë unë nuk kam  
7 punuar më me të.

8 Tani po më thoni që të përmend artikuj që kam shkruar.  
9 Unë nuk e kam idenë çfarë artikujsh kam shkruar. Po ju them që  
10 kam shkruar shumë artikuj. Pse duhet të mbaj mend unë një  
11 artikull të caktuar që kam shkruar që shoqërohej nga  
12 fotografitë e bëra nga z. Dobricic. Pse duhet ta mbaja mend  
13 këtë gjë? Thjesht po ju them që kjo ishte punë e zakonit që  
14 bëja. Unë shkruaja artikuj, artikujt dërgoheshin në Beograd.  
15 Ato transmetoheshin apo jo nuk e di nëse pëlqeheshin apo jo  
16 dhe kaq ishte.

17 PY. Le të kthehemi përsëri te z. Dobricic. Ne ju thamë dje që  
18 z. Dobricic është marrë në pyetje nga një gjyqtar-hetues. Një  
19 gjykatës hetues serb. Ju kujtohet kjo pjesë e diskutimit dje?

20 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na jepni një  
21 referencë për dokumentin që përmendët?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, është deklarata e z. Dobricic.  
23 Dokumenti identifikohet si 083812 deri në 083122. Është  
24 dëshmitari 4828 dhe faqja që përmendëm dje ishte faqja 083813.

25 PY. Pra, duke iu kthyer edhe një herë temës. Z. Dobricic

1 është marrë në intervistë nga një gjykatës hetues në vitin  
2 1999. A po dëshmoni përpara Trupit Gjykses sot që ju nuk jeni  
3 intervistuar asnjëherë nga një gjykatës hetues serb, këtë po  
4 thoni? E vërtetë është kjo?

5 PË. Jam intervistuar vetëm kur jemi liruar me datë 27 nëntor.  
6 Erdhi për të na marrë Walker dhe dhamë një konferencë për  
7 shtyp të nesërmen në mëngjes nga ora 10.00-10.30 e mëngjesit.  
8 Mund të vazhdoj më tej?

9 Pra, rreth orës 10.00-10.30 të mëngjesit dikush i ra  
10 derës së apartamentit tim dhe përderisa ishte pranë derës  
11 pashë se kush ishte, kush po trokiste në derë. Nuk e njoha  
12 personin, mora në telefon babain tim për të parë se kush  
13 ishte, pastaj e hapa, e hapi derën im atë. Im atë njihej nga  
14 njerëzit, shumë njerëz e njihnin, kështu që kur u hap dera  
15 personi që ishte pas dere pyeti, "Z. Radosevic është këtu apo  
16 jo?". Ishin tre apo katër burra edhe këta persona më thanë, "A  
17 mund të vini me ne në rajonin e policisë?". "Në rregull", -  
18 thashë unë. U veshja, shkova me ta, qëndrova aty rreth një orë,  
19 një orë e gjysmë dhe ata më bënë pyetjet lidhur me ngjarjet që  
20 kemi diskutuar dje dhe sot për dyzet ditët që kam shpenzuar,  
21 kam kaluar i ndaluar. Për shembull, e mbaj mend se çfarë dite  
22 ka qenë. Megjithatë, e mbaj mend që ka pasur një ndeshje  
23 futbollit ndërmjet Jugosllavisë dhe, jo një ndeshje volejbollit  
24 ndërmjet Kubës dhe Jugosllavisë. Kam përshtypjen që ishte data  
25 28. Megjithatë, mbase kjo nuk është e rëndësishme.

1 Pra, ishte një takim që zgjati një orë, një orë e gjysmë,  
2 pastaj u largova. Pastaj erdhën kolegët e mi nga Tanjug-u. Më  
3 morën për drekë dhe ne diskutuam se çfarë kishte ndodhur. Pra,  
4 ky ishte i vetmi rast kur dikush më ka intervistuar mua lidhur  
5 me atë çfarë kishte ndodhur.

6 PY. Pra, ju po dëshmoni sot që e vetmja herë që ju kanë marrë  
7 në pyetje lidhur me atë çfarë ju kishte ngjarë ishte një polic  
8 vendor, kështu?

9 PË. Vetëm atëherë më kanë pyetur. Asnjëherë askush tjetër nuk  
10 më ka pyetur.

11 PY. Pra, po na thoni që nuk keni shkuar asnjëherë përpara një  
12 gjykatësi-hetues si Z. Dobricic për t'i treguar gjykatësit se  
13 çfarë kishte ndodhur në nëntor, në tetor-nëntor '98-s. Këtë po  
14 thoni?

15 PË. Ekzaktësisht këtë po them. Të nesërmen në mëngjes pasi u  
16 liruam shkova në rajonin e policisë. Kam qëndruar diku më  
17 tepër, sesa një orë aty. Më bën ca pyetje dhe kaq. Absolutisht  
18 asnjë gjë tjetër.

19 Nuk e di se për çfarë e ka pyetur gjykatësi-hetues  
20 kolegun. Ndoshta është marrë në pyetje nga të njëjtët persona.  
21 Unë po ju them që ishin thjeshtë policitë në sektorin e  
22 sigurisë publike.

23 PY. Pra, kur ju pyeti polici juve ose policia, ju thatë që  
24 kishit vozitur makinën në një grup ushtarësh të UÇK-së pa  
25 ndalur dhe pastaj u kthyet mbrapsht dhe pastaj ju ndaluan këta

1 pjesëtarë të UÇK-së, këtë i treguat, çfarë i thatë atyre që ju  
2 morën në pyetje?

3 PË. Po, po. Sigurisht të njëjtën gjë që jua thashë dhe juve,  
4 ju kam thënë edhe atyre.

5 PY. A mund të na thoni ndonjë arsye që pasi ato çfarë i keni  
6 thënë ZPS-së, domethënë a ka, si mund ta shpjegoni faktin që  
7 z. Dobricic është ftuar që të flasë me një gjykatës-hetues dhe  
8 juve s'ju ka kërkuar njeri fare që të jepnit dëshminë tuaj  
9 përpara gjykatësit-hetues. Si mund të ketë ndodhur kjo? Mund  
10 të na e shpjegoni?

11 PË. Këtë pyetje duhet t'ia bëni gjykatësit hetues, jo mua.

12 PY. Në fakt, zotëri, unë them që ju jeni thërritur nga  
13 gjykatësi-hetues. Gjykatësi-hetues e ka marrë deklaratën tuaj  
14 edhe deklarata juaj është fshehur tani nga kjo Gjykatës, nuk i  
15 është treguar Gjykatës ose informacioni që i keni dhënë  
16 policisë për të gjitha këto tema nuk çoi në hetimet të  
17 mëtejshme, sepse nuk kishte ndodhur asgjë për të bërë hetime  
18 të mëtejshme. O njëra, o tjetra, është e saktë kjo?

19 PË. Nuk e kuptoj. Çfarë doni të thoni që "nuk ka ndodhur  
20 asgjë"?

21 Z. BOYLE: [Përkthim] E kundërshtojmë. Cili është themeli  
22 i këtij konstatimi? Nga ta dijë dëshmitari se çfarë kanë  
23 vendosur autoritetet gjyqësore?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë,  
25 keni një provë apo është thjesht një parandalim?

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, thjesht unë po i them që çfarë  
2 pozicioni ka ai drejtpërsëdrejti.

3 PY. Zotëri, pas bisedës që patët ju me policinë të nesërmen e  
4 asaj çfarë kishte ndodhur, nuk ndodhi asgjë më. Domethënë, i  
5 gjithë informacioni që i treguat Prokurorisë që jeni abuzuar,  
6 që policët, domethënë, këtë ia treguat policisë juve? Çfarë i  
7 keni thënë ZPS-së?

8 PË. Po, sigurisht që ia thashë. I tregova se si na kapën e të  
9 gjitha gjërat e tjera. Dhe i dhashë edhe përgjigje të njëjtat  
10 përgjigje edhe Prokurorisë për të gjitha pyetjet që më kanë  
11 dhënë. Po jua them edhe juve që ishin katër a pesë vetë  
12 thjesht ju tregova se çfarë kishte ndodhur. Pra, ndër të  
13 tjera, neve kemi parë këtë ndeshjen e volejbollit ndërmjet  
14 Kubës dhe Jugosllavisë ose Brazilit dhe Jugosllavisë.  
15 Domethënë, ndërkohë që po diskutonim, po shikonim edhe  
16 ndeshjen. Dhe kjo transmetohej në televizion. Mbase mund t'ju  
17 duket për të qeshur kjo, por kështu ka ndodhur.

18 PY. Pra, çfarë po thoni ju është që, pasi i treguat policisë  
19 se çfarë ju kishte ndodhur ju nuk jeni përfshirë fare në asnjë  
20 hetim tjetër lidhur me ngjarjet që ju kishit ndodhur dhe që i  
21 keni treguar për këtë ngjarje ZPS-së. Këtë po thoni?

22 PË. Po, ekzaktësisht kështu. Herën e parë që më kontaktoi  
23 dikush ka qenë në 2011 kur erdhi EULEX-i, a nuk e di se si e  
24 kanë emrin, se si i quani ju ata.

25 PY. Në rregull, le të përqendrohemi pak këtu. Domethënë, le

1 të shohim pak se si kanë qenë zhvillimet e ngjarjeve. Ju i  
2 keni thënë ZPS-së dhe për herë të parë që në 2011-2012 jeni  
3 çuar në Sedllar në një vend në Shallë, në Sedllar në serbisht.  
4 Dhe që ju vendos një armë në gojë, kështu, këtë thatë?

5 PË. Po.

6 PY. Atëherë kjo jepet dokumentin 000781 deri në 007819 [sipas  
7 përkthimit]

8 PËRKTHYESI: Do i kërkonim Avokatit që të lexojë pak më  
9 ngadalë për t'u kapur plotësisht.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është e  
11 nevojshme që ta tregoni dokumentin se -

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është prova materiale P489  
13 për procesverbal.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që nuk e thashë  
15 numrin e provës materiale.

16 PY. Në 2011 ishte hera e parë që i ke thënë dikujt që të kanë  
17 vënë armën në gojë, në sy. Është e vërtetë kjo?

18 PË. Pra, zyrtarisht po. Mbase këtë e kam thënë në intervistën  
19 në 1998 në televizionin BK kur na kanë ftuar, por nuk është se  
20 e kam regjistruar këtë emisionin televiziv. Mund të ketë  
21 ngjarë që e kam thënë dhe atëherë, por është e pamundur që të  
22 gjendet në qoftë se e kam thënë apo jo. Këtë gjë nuk e gjejmë  
23 dot sot. Dhe sigurisht që këtë ia kam thënë të gjithë  
24 personave që kisha aty afër, shokëve, miqve, por zyrtarisht  
25 kjo është ajo çfarë ka ndodhur, kjo që sapo na shpjeguat ju



1 tani.

2 PY. Ju thoni që zyrtarisht në 2011, por ju keni qenë gazetar  
3 gjatë gjithë kohës apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Por a shkruat ju lidhur me atë çfarë ju kishte ngjarë?

6 Çfarë ju kishte ndodhur?

7 PË. E keni fjalën për veten time në qoftë se u ula për të  
8 shkruar ndonjë gjë për veten time lidhur me ato çfarë kishte,  
9 ç'më kishte ndodhur?

10 PY. Po.

11 PË. Domethënë, nuk e di në qoftë se keni ndonjë qëllim  
12 konkret apo nuk e di pse po ma bëni këtë pyetje. Jo, nuk kam  
13 shkruar gjë.

14 PY. Keni dhënë një intervistë në 2018 përpara sesa të jepnit  
15 dëshminë tuaj, deklaratat tuaj në vitin 2011. Pyetja që kam  
16 për juve është, a keni shkruar ndonjëherë ndonjë artikull në  
17 Tanjug lidhur me çfarë ju kishte ndodhur juve në atë periudhë,  
18 pra, me ngjarjet në fjalë?

19 PË. Jo.

20 PY. Domethënë, nga 1998 deri në 2011 dhe në 2012, hera e parë  
21 që u e përmendni atë çfarë ju kishte ndodhur ishte në 2011,  
22 2012, kështu? Dhe a keni dorëzuar ju ndonjë ankesë penale, në  
23 një çështje penale tek organet përkatëse për të hetuar më tej  
24 lidhur me këtë rast?

25 PË. Jo, mund t'jua shpjegoj arsyen pse. Përgjigja për pyetjen

1 tuaj është jo.

2 PY. Domethënë, jo.

3 PË. Jo.

4 PY. Është fakt, zotëri, që kur u pyetët se çfarë ka ndodhur  
5 në Shalë dhe pse intervista në kanalën Vice.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe për procesverbal është dokumenti  
7 494.

8 PY. Aty ju bënë pyetje lidhur me trajtimin tuaj dhe ju thatë  
9 që pjesën më të madhe të rasteve ishte e denjë, ishte i denjë  
10 trajtimi. Na është dhënë ushqim, cigare, ujë, dy-tre vakte në  
11 ditë. Trajtimi më i mirë ka qenë kur kemi qenë në fshat, ku  
12 kemi qëndruar rreth një javë. Nuk kemi pasur asnjë dhunë  
13 fizike.

14 A ia keni thënë këtë gjë?

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal është ose në faqen  
16 5 ose në 15. Në faqen 114279 në provën materiale 494.

17 PY. A e keni thënë këtë gjë, Dëshmitar?

18 PË. Po. Dhe sikurse e thashë ajo çfarë ju përshkruat ishte  
19 kryesisht e saktë dhe kur shkova në ngjarje tregova për  
20 personin që më vendosi armën në gojë. Për pjesën më të madhe  
21 të përshkrimit kjo ka qenë situata.

22 Ju mund ta interpretoni si të doni, por unë kam thënë që  
23 kryesisht trajtimi ka qenë i mirë dhe unë gjithmonë kam folur  
24 për gjëra që kanë ndodhur realisht. Unë nuk kam thënë që nuk  
25 ka ndodhur asgjë, por kam thënë që për pjesën dërrmuese

1 sjellja ka qenë korrekte.

2 PY. Ju keni thënë që trajtimi më i mirë ka qenë atë javën që  
3 keni qëndruar në fshat. Nuk është ushtruar dhunë fizike mbi  
4 ju. Këtë i keni thënë kanalit Vice. Kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe tani po na thoni që pasi nuk bëtë asnjë padi penale  
7 na paskan ndodhur gjëra të tjera të llojit që dikush ju ka  
8 vënë armën në gojë. Këtë po thoni?

9 PË. Mund të përgjigjem vetëm duke ju bërë një pyetje: ku do  
10 ta çoja unë padinë penale? Ku do e dorëzoja? Ndër të tjera me  
11 kë duhet që ta bëjë këtë padi penale?

12 PY. Zotëri, po i thoni Trupit Gjykues se si gazetar i Tanjug-  
13 ut për dekada me radhë nuk keni fare informacion, nuk e di  
14 fare se ku dhe si duhet të dorëzohet një padi penale? Këtë po  
15 i thoni Trupit Gjykues?

16 PË. Jo. Por thjesht po pyes. Kujt duhet t'ia dorëzoja këtë  
17 padi? Me kë? Për kë? Shteti ishte në luftë me ta. Për çfarë  
18 qëllimi do ta bëjë unë një padi të tillë, kundër kujt duhet ta  
19 bëjë këtë padi? Nuk e kuptoj. Domethënë nuk i kuptoj të gjitha  
20 këto pyetje kujt duhet t'ia bëja, për çfarë, pse, çfarë të  
21 thoja? T'i thoja shtetit që po bëj këtë padi penale kundër  
22 UÇK-së, sepse UÇK-ja më ka mbajtur të ndaluar për 40 ditë, por  
23 ndërkohë vendi im ishte në lufte me UÇK-në.

24 PY. Këto ngjarjet në Shalë për të cilat ju nuk shkruat asnjë  
25 artikull apo as në Tanjug apo asgjëkund tjetër. Jo, do ta them

1 ndryshe. Besoj se ju keni miq në media apo jo, shokë që  
2 punojnë në media, është e vërtetë kjo?

3 PË. Po, vazhdoni, vazhdoni pyetjen.

4 PY. A keni shokë ju në media?

5 PË. Po.

6 PY. Pra --

7 PË. Jo, nuk kisha.

8 PY. Atëherë ju nuk keni shkruar asnjë artikull dhe nuk i keni  
9 treguar asnjëherë asgjë as ambasadorit Walker për armën që ju  
10 fut në gojë edhe që ju drejtua në sy, kështu?

11 PË. Këtë po thoni ju. Ti po thua që unë s'i kam thënë asgjë  
12 ambasadorit Walker.

13 PY. Nuk i ke thënë asgjë ambasadorit Walker që dikush ju vuri  
14 armën në gojë apo i keni thënë?

15 PË. Sigurisht.

16 PY. I ke thënë?

17 PË. Po, i kam thënë lidhur me këtë dhe shumë lidhur me shumë  
18 gjëra të tjera që kanë ndodhur atje, përfshirë dhe këtë gjë. I  
19 kam thënë shumë gjëra të tjera, përfshirë edhe këtë fakt.

20 PY. Kur iu bë pyetja lidhur me këtë pikë nga ZPS-ja juve i  
21 keni thënë Prokurorit që i keni thënë z. Walker që disa gjëra  
22 nuk ishin të këndshme. Sipas shënimit të Prokurorisë nuk  
23 thuhet asgjë që ju i keni thënë z. Walker që ju ka vënë dikush  
24 armën në gojë apo në sy, është e vërtetë kjo apo jo?

25 PË. Nuk e di, nuk e di a i kam thënë a jo, por sigurisht që i

1 kam thënë. I qëndroj kësaj që po them tani. Me siguri që ia  
2 kam thënë atij këtë gjë. 100 për qind i sigurt që ia kam  
3 thënë.

4 PY. Kur po flisnit me Prokurorin para pak ditësh më datën 6  
5 tetor, a i thatë Prokurorit që keni folur, keni biseduar me  
6 ambasadorin Walker për këtë ngjarje në Shalë që dikush ju ka  
7 drejtuar armën në sy dhe ju ka futur armën në gojë, ia thatë  
8 këtë gjë Prokurorit?

9 PË. Unë fola me Prokurorinë lidhur me këtë kur ne u liruar  
10 rrugës për në Prishtinë dhe i thashë Prokurorisë se çfarë kemi  
11 diskutuar në atë rast. Përfshirë edhe ku mund të shkoje në  
12 Prishtinë, ku mund të hahet mirë në Prishtinë, cilat janë  
13 gjërat interesante për t'u parë në Prishtinë, përfshirë edhe  
14 gjëra që nuk janë të këndshme për të cilat po bisedojmë tani.  
15 I thashë Prokurorit, gjithashtu që bisedova me z. Walker që  
16 shkova në familje, që u bë konferenca për shtyp edhe në fund  
17 fare e ftova z. Walker që të vinte për një vizitë në shtëpinë  
18 time. Ai erdhi, qëndroi aty për rreth gjysmë ore, së bashku me  
19 ndihmësin e vet, a nuk e di kush ishte ky personi tjetër. Dhe  
20 ai ishte i lumtur që e ftova të vinte për vizitë.

21 PY. Ju thoni që pastaj u dërguat në, domethënë, nga Shala u  
22 dërguat në një bodrum tjetër, kështu keni thënë, në një bazë  
23 tjetër, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. I keni thënë ZPS-së që ju besoni që ky vendi ku u dërguat

1 ishte në Kleçkë, është e vërtetë kjo?

2 PË. Po. Sa për të qenë të qartë, i kam thënë Prokurorit që  
3 mendoj, jo se isha i sigurt, por mendoj se vendi ishte në  
4 Kleçkë. Duke gjykuar mbi bazën e asaj çfarë kisha dëgjuar  
5 gjatë rrugës. Mund të jap informacion shtesë ose mund të më  
6 jepni pyetje për t'ju shpjeguar. Nuk thashë që isha 100 për  
7 qind i sigurt, por mendoja që ishte Kleçka.

8 PY. Dhe gjatë rrugës nga Shala në këtë vendin tjetër i keni  
9 thënë ZPS-së dhe për procesverbal kjo thuhet në provën  
10 materiale 488, Pjesa 1.1, në faqen 19, rreshti 18 deri në 23.  
11 Ju thoni që keni udhëtuar dy apo tri orë me makinë edhe i keni  
12 thënë Prokurorit që pavarësisht se ku mund të ketë qenë ky  
13 vendi, keni vozitur me makinë dy apo 3 orë nga Shala, kështu  
14 domethënë nga Shala në këtë vendin tjetër që keni shkuar ju  
15 është dashur të udhëtoni dy-tre orë, kështu?

16 PË. Po. Po ecëm në rrugë të pashtuara, pastaj kaluam në një  
17 rrugë të shtruar në asfalt mbështetur në ndjesinë që na u  
18 krijua kur ishim në automjet kur u dërguam me makinë atje.  
19 Rruga ishte kaq e gjatë, ndërkohë ndalua për pak minuta, për  
20 10-15 minuta diku dhe pastaj mbërritëm në destinacion mbas dy  
21 apo dy orë e gjysmë.

22 PY. A i thatë ZPS-së që ecën nëpër këto rrugë të shtruara me  
23 asfalt e ca të pashtuara, ia keni thënë Prokurorit këtë gjë  
24 apo po e sajoni sot, po e thoni sot për herë të parë këtë gjë?

25 PË. Nuk e kuptoj pyetjen. Ne kemi ecur me makinë. Ishin rrugë

1 të ndryshme, nuk kishte autostradë. Po ju them që gjithë  
2 rrugëtimi ndodhi dy orë, dy orë e gjysmë, kaq e gjatë ishte  
3 rrugëtimi. Dhe ishim këto rrugët. Domethënë, pse është e  
4 rëndësishme kjo? Un po ju them se sa zgjati gjithë rrugëtimi.  
5 Pse duhet ta shpik unë këtë gjë?

6 PY. Mirë, në rregull.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Le të shohim dokumentin DHT02672.

8 Është një dokument vetëm me një faqe. Është një hartë nga  
9 Google Map. Do i lutesha Sekretares ta paraqesë në ekran.  
10 PY. Dëshmitar, kjo është një pamje e Google Map që tregon se  
11 cila është distanca nga Shala deri në Kleçkë, gjithsej është  
12 9.7 kilometra që është 15 minuta larg. Me fjalë të tjera Shala  
13 nga Kleçka është larg 15 minuta me makinë. Ju e dini që gjatë  
14 '98 e gjithë kjo zonë ishte zonë e UÇK-së, thuajse e gjitha,  
15 kështu?

16 PË. Në rregull.

17 PY. Pra, ky udhëtimi 15 minutësh, ti po na thua që juve ju  
18 janë dashur dy deri në tri orë për të shkuar nga Shala në  
19 Kleçkë, kështu?

20 PË. Mund të përgjigjem?

21 PY. Po, patjetër.

22 PË. Atëherë do i kthehem edhe një herë pikës së parë. Unë  
23 thashë që mendoj se ishte Kleçka, nuk është se thashë që isha  
24 i sigurt që ishte Kleçka. Sepse na sollën vërdallë me makinë  
25 ato dy orë apo tri orë, kjo nuk është një pyetje që më duhet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe [Vazhdim]

Faqe 32

1 bërë mua. Është pyetje që duhet bërë atyre që më çuan mua në  
2 vendin. Unë nuk është se po e ngisja, nuk po e vozisja unë  
3 makinën dhe përgjegjësia nuk është e imja. Në qoftë se kemi të  
4 bëjmë me Kleçkën, se ju thashë që nuk e di me siguri që ishte  
5 Kleçka, sepse iu desh aq gjatë atyre për të na çuar në Kleçkë  
6 unë nuk e di. Ju thashë që bëmë edhe ca pushime 10 a 15  
7 minuta.

8 PY. Ju e lidhët vendin ku u dërguat me Kleçkën se ky është  
9 një vend që njihet ku për të cilin Fatmir Limaj është akuzuar  
10 që ka vrarë policë. Dhe unë po ju parashtroj, zotëri  
11 Dëshmitar, që arsyeja që pse ju thatë që mendonit që ishte  
12 Kleçka ishte pikërisht prej kësaj lidhjeje që bëtë, kështu?

13 PË. Do ju them unë për Kleçkën, sepse mendoj që jemi dërguar  
14 me makinë atje dhe që munda ta lexoni dhe në dokumente. Dikush  
15 e ka përmendur, jo personat që na kanë vozitur neve në makinë  
16 por disa njerëz që ishin në anë të rrugës që përmendnin  
17 Kleçka, Kleçka që i kam dëgjuar. Nga ana tjetër kur kam qenë  
18 në rajonin e policisë me 28, në rajonin e policisë i kam  
19 treguar policit që më mori në intervistë, që më kanë dërguar  
20 me makinë diku. Dhe ata më thanë të njëjtën gjë, të paktën me  
21 sa më kujtohet sot dhe më thanë që Nesho, me siguri të kanë  
22 dërguar në Kleçkë. Prandaj po them që ajo çfarë po them unë që  
23 mund të ketë qenë Kleçka mbështetet tek fakti që çfarë kam  
24 dëgjuar nga këta personat në rrugë dhe çfarë dëgjova në  
25 rajonin e policisë. Asnjëherë nuk kam thënë me siguri që bëhej



1 fjalë për Kleçkën, por thjesht kam thënë që, mendoja që ishte  
2 Kleçka.

3 PY. Zotëri, ju thoni që keni qenë në Kleçkë dhe pastaj thoni  
4 që kjo është piku ku ju kanë mbajtur të ndaluar i ngjasonte  
5 asaj Shtëpisë së Verdhë. Nuk keni thënë një gjë të tillë?

6 PË. Unë thashë që këto shtëpi ishin të ngjashme, dukeshin se  
7 ishin të njëjta. Në asnjë mënyrë nuk kam bërë ndonjë lidhje me  
8 ndonjë shtëpi të verdhë. Unë thashë që ishin të ngjashme. Dhe  
9 nëse ngulni këmbë unë i kam thënë që duket si kjo shtëpi, si  
10 kjo shtëpi siç duket e verdhë. Është një shtëpi malore që  
11 ishte e ndryshme nga shtëpitë e shqiptarëve në Podujevë të  
12 cilat ishin të rrethuara me mur.

13 Kjo ishte thjesht një shtëpi në një mal; kishte shkallë  
14 për të ngjitur dhe e përsëris që unë këtë e kam parë vetëm në  
15 orën 8 apo 8 të darkës, kur kam marrë disa gjëra nga atje.  
16 Nga, kur kam nxjerrë kovën në të cilën bënin nevojat personale  
17 unë kisha sa kam dalë nga kjo shtëpi për të zbrazur këtë kovë.  
18 Pra, po shpjegoj që ishte një shtëpi e thjeshtë nga ato malore  
19 dhe nuk kam bërë ndonjë lidhje me ndonjë shtëpi të verdhë. Kam  
20 thënë që duket e ngjashme me këtë shtëpi. Jo, nuk e thashë një  
21 gjë të tillë.

22 PY. Nuk e keni thënë? Nuk keni thënë që ishte e verdhë?

23 PË. Jo, unë nuk kam thënë që dukesh si Shtëpia e Verdhë; unë  
24 kam thënë që dukej si të gjitha shtëpitë e tjera në mal aty.  
25 Ka një ndryshim midis këtyre dy gjërave. Nuk kam thënë që

1 duket si Shtëpia e Verdhë. Ishte një shtëpi e zakonshme malore  
2 e cila i ngjasonte asaj shtëpie që në fakt qëllloi që ishte e  
3 verdhe.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Po t'i hedhim një sy këtij dokumenti  
5 të provës materiale P488.1, 070725, ju kërkoj ndjesë, është  
6 Pjesa e dytë në fakt. Faqja 5 deri në 19, rreshti 6.

7 PY. Ju thatë, i thatë ZPS-së:

8 "Është e ngjashme me Shtëpinë e Verdhë...".

9 I thatë që ishte e ngjashme, por dukej si Shtëpia e  
10 Verdhë dhe nuk i keni thënë ju këtë? Këtë i keni thënë ZPS-së,  
11 kjo është provë materiale.

12 PË. Nuk e kuptoj. Është thjesht çështje e gjuhës serbe. Mund  
13 ta përdorësh si të duash, nuk thashë që ishte ajo shtëpi.

14 PY. Ju po përpiqeshit që ta lidhnit atë me Shtëpinë e Verdhë  
15 për të cilën kishit lexuar në raportin e Dick Marty para se  
16 t'i jepnin intervistën ZPS-së apo jo?

17 PË. Kjo është krejtësisht e pasaktë. Nuk jam dakord fare me  
18 atë që keni thënë. Unë thashë që ishte thjeshtë e ngjashme me  
19 ato.

20 PY. A keni qenë ndonjëherë në Shtëpinë e Verdhë?

21 PË. Jo.

22 PY. A kishte çatinë me tjegulla apo të sheshtë? A e dini?

23 PË. Me sa më kujtohet ka qenë çati e pjerrët me tjegulla por  
24 nuk më kujtohet. Unë di thjesht që ishte një shtëpi e thjeshtë  
25 në mal me një çati të pjerrët.

1 PY. Pra, shtëpia ku ju kanë mbajtur të parandaluar ishte një  
2 shtëpi me një çati prej tjegullash apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Po e dini gjithashtu që Shtëpia e Verdhë i kishte çatinë  
5 të sheshtë apo jo?

6 PË. Po unë po flas, nuk di ç'të them.

7 PY. Të përqendrohemi tani për periudhën e kohës kur ju kanë  
8 mbajtur të paraburgosur në atë bodrum. Ju thoni që kur keni  
9 qenë atje ju kanë vënë thikën në grykë dhe ju kanë abuzuar. A  
10 të kujtohet ta kesh thënë një gjë të tillë?

11 PË. Po.

12 PY. Meqë ra fjala, a ia keni thënë policit atje mbas liritimit  
13 se si ju kanë vendosur këtë thikën në grykë?

14 PË. Po. Më datë 28, më 28 nëntor.

15 PY. Po me sa dini ju nuk është bërë ndonjë hetim nga  
16 gjykatësi hetues për të parë se si kishte ndodhur ky sulm i  
17 pretenduar fizik ndaj jush. Kështu është?

18 PË. Nuk më ka informuar askush lidhur me këtë. Pra, që të  
19 ketë patur ndonjë hetim. Unë kam biseduar me policinë.

20 PY. Më lejoni të lexoj atë që keni thënë ZPS-së.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe kjo është në faqen 488.1, faqja  
22 23, rreshti 1 deri 11.

23 Pyetje:

24 "Po lëndimi që keni marrë ju dhe z. Dobricic" dhe aty po  
25 flisnim për bodrumin. "A mund t'ju kujtohet se në cilën pjesë

1 të trupit”?

2 Ju u përgjigjët:

3 “Nuk ishte, më gjuajtën disa shpulla. Ndoshta isha skuqur  
4 në fytyrë, por nuk kishte asgjë që të ishte e dukshme”.

5 A ia keni thënë këtë gjë atyre apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Në intervistën e 2012 që është prova materiale P490 dhe  
8 faqen 9205 ju pyetën:

9 “PY. Çfarë ju ka ndodhur gjatë atyre 16 ditëve?

10 “PË. Asgjë e veçantë. Nuk na kanë keqtrajtuar. Ne nuk i  
11 kishim duart e lidhura dhe as sytë jo”.

12 A i keni thënë këtë hetuesit?

13 PË. Për të cilat 16 ditë e keni fjalën?

14 PY. Këtu po flitet për 16 ditët që keni qenë në bodrum kur  
15 ishit larguar nga Shala.

16 PË. Po ekzaktësisht këtë po them. Ne ishim atje të lirë në  
17 këtë 16 ditë. Ne kemi patur edhe një qiri dhe nuk shoh që të  
18 ketë patur, të ketë ndonjë kontradiktë këtu apo ndonjë  
19 kundërshti. Përveç atyre dhjetë minutave a kështu me radhë ne  
20 ndenjëm atje për 16 ditë me radhë. Askush nuk na ka prekur.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] U kërkoj ndjesë përkthyesve pasi po  
22 flas jashtë radhe, po mbivendos fjalët.

23 PY. Pra, ju po thoni që nuk ju ka ndodhur asgjë e veçantë.

24 Nuk jemi keqtrajtuar.

25 PË. Me përjashtim të momentit kur sapo arritëm.

1 PY. Pra, zotëri e keni fjalën kur sapo arritët dhe më pas u  
2 thatë hetuesve në vitin 2018 që nuk ka ndodhur asgjë e  
3 veçantë. Që pavarësisht se çfarë ka ndodhur lidhur me këtë  
4 incident me thikën, ju nuk e keni trajtuar atë si gjë të  
5 veçantë, pasi thoni që nuk jeni keqtrajtuar.

6 Z. BOYLE: [Përkthim] Kjo është keq, një përfaqësim i  
7 gabuar i provave që kemi para nesh.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.  
9 Mund të përgjigjeni.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Po përsëris. Kur arritëm ndodhi  
11 ajo që ndodhi. Pas 16 ditësh dhe pastaj për 16 ditë me radhë  
12 asgjë e veçantë nuk na ka ndodhur, s'na ka prekur njeri me  
13 dorë dhe nuk shoh asnjë kontradiktë këtu. Ndoshta është mënyrë  
14 se si është formuluar pyetja që më është bërë.

15 Z. KEHOE: [Përkthim]

16 PY. Të kalojmë në një çështje tjetër. Ne kuptojmë zotëri.

17 Më pas ju folët lidhur me dy policët që thoni që keni  
18 parë në këtë vend.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe po ju lexoj. Dhe kjo është në  
20 488.3 dhe faqja është, faqja 5, rreshti 19 deri në faqen 6,  
21 rreshti 10. Do të lexoj vetëm një pjesë të saj.

22 PY. Në këtë bodrum ju thoni apo i thatë ZPS-së se kishit parë  
23 se ç'ju kishte ndodhur këtyre dy policëve. Kështu është?

24 PË. A mund ta shpjegoni për çfarë e keni fjalën që "i kam  
25 parë"?

1 Do të vazhdojmë? Doni të shpjegoj se çfarë kam parë?

2 PY. Më lejoni të lexoj çfarë i keni thënë ZPS-së:

3 "Ne u futëm në këtë bodrum. Pas një gjysmë ore na  
4 keqtrajtuan. Shkurtimisht dhe nuk do të them në hollësi, dhe  
5 ata nxorën dikë përpara shtëpisë dhe nga ajo dritarja e vogël  
6 ne pamë disa prej tyre dhe pamë këmbët e këtij të riu që ishte  
7 me uniformë".

8 Në shënimin e seancës përgatitore para kësaj dëshmie, që  
9 është prova materiale 490, ju thatë, që katër deri pesë orë më  
10 vonë patë këmbët e një polici me uniformë jashtë kësaj  
11 dritare. Këtij personi të cilit ishte rrahur për rreth 30 apo  
12 40 minuta, mbasi apo në fakt thatë që ishte rrahur për rreth 3  
13 orë me radhë. A e keni thënë që në dy raste të veçanta keni  
14 shikuar nga dritarja dhe keni parë këtë polic apo këta policë.  
15 A e keni thënë një gjë të tillë?

16 PË. Po, atë thashë. Pas gjysmë ore ky i ri, polici, pashë  
17 këmbët e tij me uniformën blu të policisë. Në fakt me lara-  
18 lara. Atë po e rrihnin. E pyesnin se përse nuk fliste shqip e  
19 kështu me radhë. E rrahën për rreth 10 minuta dhe më pas e  
20 kthyen në dhomën ngjitur me tonën në atë bodrum. Dhe ne  
21 dëgjuam për një polic tjetër lart dhe i rrahën për rreth tri  
22 orë me radhë. Ne dëgjuam britmat nga lart dhe kjo deri në  
23 momentin kur ata erdhën dhe na treguan diçka që po ndodhte  
24 atje lart.

25 PY. Dhe i thatë ZPS-së në intervistë në dhjetor të 2019 që

1 kishit parë këtë nga dritarja e vogël, kështu është?

2 PË. Po, ishte një dritare e vogël. Në një lartësi 2 deri në 3  
3 metra shihej diçka. Ishte, ishte vonë në darkë, por shihej.  
4 Është drita e maleve atje.

5 PY. Pra, a ju kujtohet që i keni thënë, që keni dhënë një  
6 intervistë në shkurt të 2020 rreth një viti më vonë kur  
7 diskutuat këtë çështje në qendrën e shtypit të gazetarëve të  
8 Serbisë:

9 "Si mund të them? Si kemi qenë në situata në gjendje të  
10 mjerueshme në këtë bodrum ku nuk ka patur dritare".

11 A nuk e keni thënë këtë në një intervistë për shoqatën e  
12 gazetarëve të Serbisë që nuk ka patur, nuk kishte dritare, një  
13 vit më vonë se intervista me ZPS-së?

14 PË. Ku e keni marrë këtë? Ku e merrni këtë?

15 PY. Atëherë le ta shohim këtë video.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë prova materiale DHT02602  
17 [sipas përkthimit]. Dhe në fakt e kam gabim kur them ishte  
18 intervistë. Në fakt ishte konferencë shtypi. Kjo është një  
19 video në 2020 jo 2000. 11 shkurt 2020, para një vit përpara  
20 deklaratës së parë për ZPS-në.

21 Ju lutem, ta dëgjojmë.

22 [Luhet videoincizimi]

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Vetëm këtë pjesë, i nderuar

24 Gjykatës. Jo të tërë.

25 [Luhet videoincizimi]

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, do ta kalojmë nga 23, nga  
2 momenti i kohës 23 minuta 20 sekonda [sipas përkthimit] deri  
3 në 24 minuta 4 sekonda.

4 PY. Z. Radosevic unë e kisha gabim përpara se ta shohim këtë.  
5 Kjo ishte rreth dy muaj pas intervistës me ZPS-në në dhjetor  
6 të 2019. Kjo në fakt është në shkurt të 2020, pra, dy muaj më  
7 vonë. Të dëgjojmë se çfarë kishit për të thënë këtu.

8 [Luhet videoincizimi]

9 PËRKTHIM: Menjëherë pas kësaj, Dobricici dhe unë, sepse  
10 nuk na lejuan menjëherë apo jo? Tani kur i hedh sytë më pas  
11 ishte gabim, vendim i gabuar, por në atë kohë ishte gjëja e  
12 duhur që të kuptonim se ku ishim dhe cila ishte gjendja në të  
13 cilën ndodheshim.

14 "Për katër ditë ne mbajtëm një grevë urie dhe pastaj  
15 kësaj erdhën dhe na thanë se do të na lironin. Që ne nuk ishim  
16 spiunë; na kishin kapur për shkak se kishim hyrë në territorin  
17 e UÇK-së pa lejen e Demaçit. Dhe më pas na dërguan në disa  
18 kodra, male; na mbajtën në disa kushte të mjerueshme. Nuk di  
19 si ta them, nën një bodrum pa dritare, nuk kishte dysheme,  
20 ishte thjesht prej dheu. Na mbajtën përreth 15 ditë".

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 PY. Pra, dy muaj pas apo më pak se dy muaj pasi i kishit  
23 treguar ZPS-së që keni parë policët nga dritarja ju thatë në  
24 këtë konferencë shtypi që po ju mbanin në një bodrum i cili  
25 nuk kishte dritare. A nuk e keni thënë një gjë të tillë?



1 PË. Është një pyetje e shkëlqyer. Faleminderit, faleminderit  
2 që më pyesni. Kur thotë nuk ka dritare domethënë që nuk ka  
3 dritare. Do të thotë që nuk ka xham. Ka patur thjesht, ka  
4 patur thjesht shufra hekuri. Kam thënë të njëjtën gjë edhe në  
5 vitin 2011 dhe më vonë. Nuk ka patur xhama. Hyn, nuk kishte  
6 dritare. Hynte bora brenda.

7 PY. Z. Radosevic, ju i thatë Prokurorisë që keni parë këtë në  
8 nga dritarja në dhjetor të 2019 dhe dy muaj më vonë ju thatë  
9 që ishit nën një bodrum pa dritare.

10 Z. BOYLE: [Përkthim] E kundërshtojmë. Kjo pyetje është  
11 bërë dhe ka marrë përgjigje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. Atë thashë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'ka nevojë  
15 që t'i përgjigjeni.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Dakord.

17 Z. KEHOE: [Përkthim]

18 PY. Ju keni hamendësuar se ato ishin policë serbë pasi keni  
19 biseduar me forcat policore të Serbisë pas lirimit tuaj.  
20 Kështu është apo jo?

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Kjo është një pyetje me shumë pjesë.  
22 Është kundërshtim.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] E ndërlikuar, kjo shumë e thjeshtë,  
24 pyetje shumë e thjeshtë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

1 Mund t'i jepni përgjigje pyetjes. A doni ta përsërisni, z.

2 Kehoe?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Dakord.

4 PY. Z. Radosevic, ju e dhatë këtë dëshmi lidhur me këto dy  
5 policë për shkak se policia vendore ju ka treguar, pas lirimit  
6 tuaj, se ishin rrëmbyer disa policë. A nuk është kështu?

7 PË. Kjo pjesë është e saktë.

8 PY. Dhe pas lirimit tuaj dhe ishte në provën materiale P93,  
9 gjatë ditës së djeshme. Kolegu juaj, z. Dobricic është pyetur  
10 lidhur me disa njerëz, me njerëz të tjerë dhe tha:

11 "Nuk kishte parë njeri tjetër të ndaluar, në asnjërin  
12 anë".

13 Këtë gjë ka thënë apo jo?

14 PË. Se ç'ka thënë ai është problemi i tij. Unë them që nuk  
15 kemi parë askënd tjetër me përjashtim të atyre dy oficerëve të  
16 policisë. Thashë që kemi parë dikë që rrihej dhe kemi parë nga  
17 kjo dritarja e vogël dhe më pas kanë rrahur këtë personin që  
18 ndodhej në katin lart. Thanë që ti je një burrë i moshuar dhe  
19 kjo të ka ndodhur. Dhe më pas e pyetën këtë të riun se cili  
20 ishte roli i tij në radhët e policisë a përse ishte polic dhe  
21 nga gjithë kjo unë arrita të kuptoja se bëhej fjalë për dy  
22 oficerë të policisë.

23 Pas kësaj kur takova këta njerëz më datë 28, njerëzit për  
24 të cilët më pyete ti, unë përmenda që kishte pasur dy oficerë  
25 të policisë atje dhe nga ato dëgjova që dy policët e vetëm që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe [Vazhdim]

Faqe 43

1 ishin rrëmbyer ishin këta të dy dhe prandaj e thashë. Unë nuk  
2 është që thashë atë çfarë thashë. Ky ishte vlerësimi i  
3 policisë që në fakt këto dy persona ishin ato dy persona të  
4 cilët ishin rrëmbyer. Po ndërkohë, s'kam parë askënd tjetër.  
5 PY. Z. Radosevic, mund të jenë dakord që çështja e rrahjes së  
6 oficerëve serbë është çështje shumë serioze, nuk është kështu?  
7 PË. Po, po jam shumë dakord. Dhe prandaj thashë që pashë dhe  
8 dëgjova se si ishte rrahur ky polic i ri. Dhe më pyesnin,  
9 pyesnin pse e bërë këtë e kështu me radhë.

10 PY. Po përpiqem që ta kaloj sa më shpejt këtë çështje. Pra,  
11 jeni dakord që kjo është një çështje serioze apo jo?

12 PË. Po, jam shumë dakord. Dhe prandaj e thashë këtë bazuar  
13 mbi atë që di dhe unë thashë pikërisht këtë që policia  
14 mendonin se bëhej fjalë për të njëjtët oficerë të policisë.  
15 Këtë kam them dhe kjo është çështje serioze.

16 PY. Dhe pasi keni folur ju me policinë vendase më datën 28  
17 nëntor sipas dëshmisë suaj asnjë gjykatës-hetues nuk të ka  
18 kërkuar që të të pyes lidhur me rrahjen e pretenduar të të dy  
19 oficerëve të policisë serbe. Kështu po thoni?

20 Z. BOYLE: [Përkthim] Është bërë kjo pyetje dhe ka marrë  
21 përgjigje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.  
23 Mund t'i përgjigjeni.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë e deklaroj dhe po e përsëris  
25 që nuk më ka pyetur askush lidhur me këtë, asnjëherë. Kanë

1 bërë si duhet punën e tyre policia, ky është problemi i tyre.  
2 Por mua nuk më ka pyetur njeri. Nuk e di nëse i kanë gjetur  
3 këto dy persona, por unë besoj se këto ishin dy persona që  
4 janë vrarë nga ato që u thanë më vonë. Po unë po ju tregoj për  
5 ato që unë di vetë. Askush nuk më ka marrë mua në pyetje.  
6 Përveç këtyre personave të EULEX-it askush nuk më ka pyetur në  
7 këtë çështje.

8 Z. KEHOE: [Përkthim]

9 PY. Dhe nga informacioni që ju i keni dhënë policisë lidhur  
10 me rrahjen e këtyre policëve ju mendoni apo me sa dini ju nuk  
11 ka ndodhur gjë tjetër?

12 PË. Unë po ju them edhe një herë që nuk di se çfarë të them.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
14 një temë tjetër. I është përgjigjur kësaj çështje.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, po kalojmë.

16 PY. Më pas keni folur lidhur me kazermën ku thoni që jeni --  
17 ju kanë sulmuar me përdorimin e një thike, kështu është?

18 PË. Jo. Mendoj se nuk di si ta them. Unë, mua nuk më ka  
19 sulmuar njeri. Po mund ta lexoni pak më qartë. Nuk dua t'ju  
20 ofendoj. Nuk ka ndodhur kështu. Në këtë kasolle ku na kanë  
21 mbajtur na kanë trajtuar mirë. Në fakt në këtë kasolle, në  
22 fakt, kemi kaluar një natë dhe një ditë, na kanë trajtuar  
23 mirë. Më mirë sesa në Shalë. Ne u lamë, u rruajta, lava  
24 çorapet, ishte ngrohtë, kishim batanije të reja. Aty ishte  
25 përgatitur ai vend për 10 apo 12 vende. Ishte krejt në

1 rregull. Nuk ka patur asgjë aty, nuk ka ndodhur asnjë lloj  
2 dhune; nuk është përmendur ndonjë thikë. Nëse ka ndonjë hutim  
3 këtu ju kërkoj ndjesë, a doni të vazhdoj?

4 PY. Dakord.

5 PË. Pra, pas qëndrimit në bodrum erdhën në darkë dhe na  
6 dërguan në këmbë, me sytë e lidhur për 1 kilometër, 1.5  
7 kilometër. Nuk i kishin duart e lidhura, pasi kishim në dorë  
8 ato çantat tona të cilat na i kishte sjellë Kryqi i Kuq që i  
9 kishte patur marrë në Shalë. Pas 1 kilometri apo 1.5  
10 kilometër, kaq zgjati rruga arritëm në këtë shtëpi, si të them  
11 këto shtëpitë me prej druri. Ishte, erdhi një i ri që kishte  
12 që ishte veshur me bluxhinse dhe me xhaketë lara-lara, doni të  
13 vazhdoj?

14 PY. Pra, çështja që po ngre unë është që ju nuk jeni  
15 keqtrajtuar në këtë çështje dhe në këtë zonë.

16 Z. BOYLE: [Përkthim] Mund të na jepni sqarime se për  
17 cilën zonë e keni fjalën para se të liroheshit?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

19 Z. KEHOE: [Përkthim]

20 PY. Na tregoni atëherë për zonën ku ishit liruar. A ju kanë  
21 abuzuar në ndonjë fare mënyrë?

22 PË. Po, po.

23 PY. A ju kanë keqtrajtuar në atë zonë?

24 PË. Në një vend tjetër, jo në këtë vendin e fundit. Një herë  
25 na kanë transferuar me një traktor përreth tri orë ka zgjatur

1 rrugë. Kjo ishte më vonë pas qëndrimit në këtë kasolle, shtëpi  
2 druri ku kemi kaluar një natë, një natë dhe më pas kemi kaluar  
3 katër, pesë ditë në një vend tjetër. Ky qëndrimi në këtë  
4 kasolle ishte thjesht një intermezo, si të thuash, interval,  
5 aty u lamë, kaluam gjithë ditën, ishte një dhomë e mirë dhe në  
6 darkë erdhi një burrë, na mori me një traktor të hapur dhe na  
7 dërgoi në një vend tjetër. Nuk e di se ku, se cili se për  
8 çfarë vendi bëhet fjalë. Nuk mund ta hamendësoj.

9 PY. Pra, ju po thoni që asnjë nga këta dy vendet nuk ju  
10 ushtrua dhunë fizike ndaj jush, kjo është dëshmia juaj?

11 PË. Tek vendi i dytë, tek vendi i dytë, a më lejoni ta  
12 sqaroj? Mbërritëm atje, ishte ora 3, 4, 5 e mëngjesit, me  
13 traktor na çuan atje, ishte duke u gdhirë. Ka qenë nëntor.  
14 Keni parasysh. Nuk më kujtohet sa ka qenë ora, por kemi  
15 vozitur rreth tre orë nëpër borë me një traktor dhe nga  
16 kasollet na çuan në një vend tjetër. Ishte vend i madh, me sa  
17 kuptuam. Na çuan në një shtëpi, në një kat sipër dhe në atë  
18 dhomë, në atë vend kishte pesë a gjashtë pjesëtar të Ushtrisë  
19 Çlirimtare të Kosovës që flinin atje. Një komandant dhe një  
20 person tjetër i zgjoi nga gjumi dhe u kërkoi të dilnin nga  
21 dhoma.

22 PY. Pyetja ime është kjo: A u keqtrajtuat apo jo në këtë  
23 vend?

24 PË. Në anglisht mund të them pak a shumë, "sort of", pak a  
25 shumë.

1 PY. Pak a shumë?

2 PË. A do më lejoni tani ta shpjegoj pse në një mënyrë po, u  
3 keqtrajtua? Po. U përpoqa t'jua shpjegoja.

4 Na akomoduan në atë dhomë, dhoma, oda ishte e madhe.  
5 Kishte batanije, kishte disa jastëkë. Kur hyje në dhomë, në të  
6 djathtë vendosën Dobricicin, ndërsa u ula ose u shtriva në mes  
7 të dhomës. Dhoma ishte 4, 5 metra. Unë u shtriva në mes të  
8 dhomës me drejtim nga dera. Asgjë nuk ndodhi atë ditë. Vetëm  
9 që personi që na priti atje na pyeti a deshëm kafe, na dhanë  
10 ushqim, gjithçka shumë mirë.

11 Por të nesërmen në mëngjes dëgjuam zhurmë, dëgjuam zëra.  
12 Po vinte dikush drejt dhomës ku ishim ne. Pastaj pesë ose  
13 gjashtë persona nga UÇK-ja mësyn në dhomë. Sapo hynë një a dy  
14 panë Kicën në të djathtë dhe filluan ta shkelmonin ose diçka  
15 të tillë. Jo, jo diçka, filluam ta shkelmonin dhe i bërtitën.  
16 3 të tjerët u erdhën në drejtimin tim. Më morën qeben dhe më  
17 zbuluan. A është e qartë deri tani? Shpresoj që po.

18 Më lejoni t'jua shpjegoj tani. Më pa që kisha çorape të  
19 bardha të pastra. Isha i rruar, i pastër, isha i rregullt, i  
20 pastër, i rruar. Jo se kisha, isha i rregullt. Me çorape të  
21 pastra dhe ishin tre metra larg meje. Njëri vendosi dorën në  
22 pistoletë, tjetri vendosi dorën në thikë. Filluam të shanin  
23 dhe po vinin në drejtimin tim. Kuptova që një prej personave  
24 ishte si shefi i tyre dhe unë në ato momente u çova në këmbë,  
25 u mbështeta me shpinë tek muri dhe thashë, "Jemi gazetarë,

1 jemi gazetarë, e thashë në shqip këtë. Jemi gazetarë nga  
2 Prishtina". Dhe u dha një komandë në shqip të ndalonin dhe dy  
3 personat e tjerë i thanë, e lanë Kicën të qetë dhe ata më  
4 pyetën në serbisht mua, "Radosheviqi je ti?". Unë i thashë,  
5 "Po, unë jam". Dhe ata më thanë, "Po pse s'na e the që në  
6 fillim?".

7 PY. Pra, ju po thoni tek vendi i dytë nuk ju kanë keqtrajtuar  
8 fizikisht apo jo?

9 PË. Po, por ju them me përjashtim të asaj që i bën Kicës dhe  
10 mbase po mos u tregoja unë kush isha, unë u thashë, jam  
11 gazetar. Prandaj po jua shpjegoj. Që këtë mund ta quaj një  
12 incident, sepse Kicën e shkellmuam disa herë, por mua nuk më  
13 preku njeri me dorë se nuk patën kohë. Dhe se i zgjidhëm  
14 gjërat dhe ai më tha, "Ah je Radosheviqi ti. Babain e ke pasur  
15 futbollist apo --".

16 Por nuk më rrahu njeri.

17 PY. Në qoftë se ju kujtohet dje pamë një filmim dhe mund ta  
18 shohim prapë sot nëse dëshironi. Është prova materiale numër  
19 93. Z. Dobricic i ka thënë medias kur ju liruan ai tha se ju  
20 nuk u keqtrajtuat, a ju kujtohet?

21 PË. Po këtë po ju thoja dhe unë. Pjesën më të madhe ishte  
22 sjellje korrekte prej tyre. Kështu e tha edhe ai. Pra, pjesa  
23 më e madhe ishte sjellje korrekte. Unë nuk po shoh ndonjë  
24 ndryshim të madh mes asaj që ka thënë ai dhe kësaj që po them  
25 unë. Unë gjatë gjithë kohës ju kam thënë që pjesa më e madhe



1 ishte korrekte. Të njëjtën gjë po themi. Pra, pjesa më e madhe  
2 ishte korrekte; sjellja ishte korrekte. Patëm këtë incidentin  
3 kur më vendosi tytën e armën në gojë, pastaj një person tjetër  
4 ishte me thikë. Mund t'i themi një incident i mundshëm. Por  
5 pjesa më e madhe e sjelljes ishte korrekte. Po unë jam ku jam.  
6 Fundja jam gjallë.

7 PY. Dobricic ka thënë në një filmim që ju nuk jeni  
8 keqtrajtuar apo jo?

9 PË. Nuk pajtohem. Ju thashë pjesën më të madhe të kohës  
10 sjellja ishte korrekte. Pjesën më të madhe. Nuk mund të themi  
11 që nuk u keqtrajtuam, por pjesën më të madhe të kohës sjellja  
12 ishte korrekte.

13 PY. Ju i keni thënë edhe ambasadorit Walker që nuk ju kanë  
14 keqtrajtuar. Dhe kjo është e reflektuar në paragrafin 19 të  
15 deklaratës së ZPS-së. Po apo jo? A nuk i keni thënë edhe  
16 ambasadorit Walker që nuk ju kanë keqtrajtuar? Kështu?

17 PË. Nuk i thashë që nuk u keqtrajtuam. A mund ta lexoni çfarë  
18 kam thënë? Mund të kem thënë që sjellja që korrekte pjesën më  
19 të madhe të kohës, diçka të tillë. Por duhet të kuptoni që më  
20 lanë të ikja në shtëpi, pjesën më të madhe të kohës ishte  
21 sjellja korrekte. Unë s'e dija ku isha, nuk e dija çfarë po  
22 ndodhte, a vazhdonin luftimet, a kishte avancuar lufta. Unë  
23 thjesht doja të rrija aty të kuptoja çfarë po ndodhte në  
24 Kosovë e në Serbi e gjithandej. Dhe unë i thashë që pjesën më  
25 të madhe të kohës sjellja ishte korrekte.

1 Nëse doni ta përsëris unë deri mund t'ju them edhe një  
2 herë, që në 2011 deri në 2012 nuk kam thënë askujt asgjë në  
3 lidhje me këtë. Dhe më pas u bë ky diskutimi dhe u thashë që  
4 pati disa incidente, por mua s'më pyeti njeri konkretisht dhe  
5 unë nuk doja të tregoja asgjë.

6 Unë po ju them edhe një herë që pjesën më të madhe të  
7 kohës sjellja ishte korrekte. Interpretimi i juaj dhe  
8 interpretimi im nuk duket sikur janë të ngjashme. Është  
9 thjesht çështje perspektive atëherë.

10 PY. Pra, a pajtoheni që ju kur keni biseduar me ambasadorin  
11 Walker i keni thënë se nuk ju kanë keqtrajtuar. A është kjo e  
12 saktë?

13 PË. Jo, nuk thashë që nuk jam keqtrajtuar. Për pjesën më të  
14 madhe të kohës sjellja ka qenë korrekte. Janë dy gjëra të  
15 ndara. Por ne nuk e diskutuam shumë. Folëm për gjëra të  
16 ndryshme, më dha një telefon satelitor të telefonoja dhe  
17 telefonova Tanjug-un. Isha i interesuar për situatën politike.  
18 A do shkojmë në shtëpi, kur do shkojmë, a ka luftë, a s'ka  
19 luftë, a ka të shtëna. Si u trajtuam, ç'rëndësi ka më u  
20 trajtuam si u trajtuam.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë.

22 Z. KEHOE: [Përkthim]

23 PY. Ju bëri pyetje Prokurori në lidhur me personat që njihje  
24 dhe po ju lexoj diçka që është reflektuar në Pjesën 2. Pra,  
25 është prova materiale 488.2, faqja 10, rreshtat 4 deri në 23.

1 Pyetja është kështu:

2 "A keni hetuar apo a jeni interesuar për personat e UÇK-  
3 së që ju ndaluan, të zbulonit identitetet dhe emrat e tyre?"

4 "PË. Jo. Përmenda një person Sokol Bashota. Ai më liroi".

5 A e dini ju në fakt që e ka urdhëruar Adem Demaçi Sokol  
6 Bashotën t'ju lironte? E dini ju këtë?

7 PË. Jo nuk e dija këtë. Nga ta di unë këtë?

8 PY. Vazhdojmë tani.

9 "Jo, vetëm një person përmenda, Sokol Bashotën. Ai më  
10 liroi. Ja dija emrin. Ishte një person serb, një person që  
11 dinte serbisht. Unë e dija që Thaçi ishte komandant i  
12 Drenicës, se unë isha atje, Drenocit. Sepse ishte '98, dhe  
13 personat që njihnim asokohe ishin Sylejman Selimi-Sulltani;  
14 Jakup Krasniqi që ishte komisari politik dhe komandanti i  
15 Podujevës, si e kishte emrin? Rama?

16 "PY. Remi."

17 PËRKTHYESI: I lutemi Avokatit të lexojë ngadalë sepse  
18 përkthyesit nuk e kanë tekstin përpara.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj falje.

20 PY. "PË. Po, Remi. Ata ishin emra të famshëm; ishin të njohur  
21 asokohe. E kisha dëgjuar për Thaçin dëgjova vetëm kur më  
22 liruar dhe ishte një fletarresti lëshur për të. Hashim Thaçi  
23 njihej si "Gjarpri". Dhe më pas filluan të dilnin dhe emra të  
24 tjera si Limaj dhe Haradinaj. Po ne si gazetarë trajtonim  
25 shumë tema, por këto ishin emrat që ne dinim asokohe".

1 Vazhdojmë pastaj në të njëjtën provë materiale, faqja  
2 488, prova materiale 488.2, rreshtat 11, 1 dhe 5. Vazhdon.

3 "A i njihni këto persona, a i keni parë personalisht  
4 gjatë ndalimit tuaj"?.

5 "Këtë po përpiqem t'ju them. Nuk mund ta them këtë. Nuk  
6 mund ta deklaroj diçka të tillë".

7 Pra, ju me sa kuptoni nuk keni parë asnjë prej këtyre  
8 personave me sytë tuaj gjatë ndalimit tuaj, po apo jo?

9 PË. Kështu, kështu thuhet këtu.

10 Ja, kështu. Edhe unë këtë po them. Nuk kam parë asnjë  
11 prej tyre atje. Me sa di unë nuk i kam parë. Me sytë e mi nuk  
12 kam parë asnjë atje. Të paktën, jo, nuk kam dijeni ta kem  
13 parë.

14 PY. Po a e dini ju që z. Thaçi nuk ka qenë asnjëherë  
15 komandant i Drenicës? E dini këtë?

16 PË. Prisni një çast, prisni një çast. Jo ta kuptoj, për  
17 përkthimin, a u përkthye, nuk po verifikoj përkthimin, por ta  
18 kuptoj.

19 Dëgjova, se kisha dëgjuar për Selimin që ishte i afërm me  
20 Adem Jasharin, Sokol Bashotën, Jakup Krasniqin, Adem Demaçin,  
21 Remin, komandanti i Podujevës. Të paktën kështu e dinim ne. Sa  
22 i takon z. Thaçi si komandant apo çfarëdo, mbase jo i  
23 Drenicës, por komandant i përgjithshëm i UÇK-së.

24 Unë për herë të parë kam dëgjuar për të kur policia në  
25 mënyrë publike theksoi që z. Thaçi ishte komandant i Ushtrisë

1 Çlirimtare të Kosovës. Nuk thashë unë i Drenicës, nuk e di si  
2 doli Drenica këtu. Unë po ju them që kur kam dëgjuar për herë  
3 të parë për këtë zotëri ka qenë më vonë, pasi më liruan. Kur  
4 policia lëshoi fletarrest për të, ku thuhej që ai ishte  
5 personi kryesor dhe ai kishte katër a pesë vartës si Limaj dhe  
6 Haradinaj, por me sa kuptova unë ai ishte në krye edhe kishte  
7 dhe një fotografi të tij.

8 Shpresoj të jemi kuptuar tani.

9 PY. Po, po e qartë është. S'ka qenë komandant i Drenicës. Kjo  
10 është e qartë.

11 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj. Mbi ç'baza po thuhet  
12 kjo?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.  
14 Dëshmitari le t'i përgjigjet në qoftë se ka informacion.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Po nuk e dija unë këtë, nga ta  
16 dija unë a ishte Hashim Thaçi komandanti i Drenicës në atë  
17 kohë apo jo? Unë Hashim Thaçin e njoha për herë të parë, emrin  
18 e tij, nga fletarrest i komandant i UÇK-së. Ishte një  
19 fletarrest i botuar në të gjitha gazetatat. Unë nuk është se ma  
20 dha mua njeri personalisht. Thjesht e mora vesh ku u bë  
21 publik. Më pas ai u bë komandant diku.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
23 përgjigjuni pyetjes. Nuk na nevojiten shumë shpjegime. Përveç  
24 nëse ju gjykoni që është shumë e nevojshme, por në këtë rast  
25 duhet të kërkonte leje për të shtjelluar më tej.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. KEHOE: [Përkthim]

3 PY. Ju asnjëherë nuk e keni takuar Thaçin apo jo?

4 PË. Po, dje. Herë e parë që e pashë zotninë ishte dita e  
5 djeshme.

6 PY. Para ditës së djeshme s'e keni parë më përpara?

7 PË. Po, kështu është.

8 PY. Pra, as s'e kishit parë më përpara, as s'e kishit takuar  
9 më përpara, as nuk e keni parë gjatë kohës që keni qenë në  
10 ndalim?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe juve ju kanë bërë pyetje për Thaçin, keni diskutuar  
13 për Thaçin dhe kjo është e reflektuar në transkriptin të cilin  
14 jua përmenda më herët që është prova materiale 488.2 dhe keni  
15 diskutuar për udhëheqësit dhe gjatë këtij diskutimi që është  
16 bërë me ZPS-në në dhjetor të 2019. Është folur për këtë. Është  
17 ajo pjesa që ju lexova pak më herët.

18 PË. Po, në rregull.

19 PY. Gjatë gjithë këtij diskutimi me ZPS-në, por edhe më  
20 përpara. Gjatë diskutimeve që keni pasur me hetuesit në 2011  
21 apo në 2012 apo intervistat që keni dhënë për platformën  
22 "Vice" në 2018, intervistën me ZPS-në në 2019, asnjëherë nuk  
23 keni përmendur gjë për, nuk e keni zënë fare në gojë  
24 kushëririn tuaj, të afërmin tuaj Major Gjeneral Dushanin, i  
25 cili ju ka përmendur ju një përgjim të një thirrjeje

1 telefonike mes Adem Demaçit dhe Thaçit. Pra, këtë nuk e keni  
2 përmendur asnjëherë.

3 PË. Ja kam thënë familjes sime, të afërmve të mi, pjesës  
4 tjetër nuk më kujtohet t'ua kem thënë këtë. Të paktën nuk e  
5 kem thënë publikisht.

6 PY. Po jua bëj edhe një herë pyetjen. S'e keni thënë as në  
7 2011; s'e keni përmendur as në intervistat e 2012; as ZPS-së  
8 në 2019 që është pranuar si provë intervista juaj, si prova  
9 materiale 488; as nuk keni thënë në këtë intervistën që keni  
10 dhënë për platformën "Vice" dhe kjo është pranuar si provë  
11 materiale. Në asnjë nga këto raste ju nuk e keni zënë në gojë  
12 dhe nuk keni përmendur që ky zotnia gjenerali juaj ka  
13 përmendur për ju, ju ka përmendur një përgjim të Thaçit dhe  
14 Demaçit. Asnjëherë s'e keni thënë apo jo?

15 PË. Po, kështu është.

16 PY. Hera e parë që e keni përmendur këtë ka qenë në  
17 intervistën e 6 tetorit 2023, para katër ditësh, saktë?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Dhe ky gjenerali, kushëriri juaj ishte figurë e  
20 rëndësishme në Kosovë gjatë kohës që ju ishit gazetar në  
21 Kosovë, në Prishtinë, apo jo?

22 PË. Kështu është.

23 PY. Ju keni folur me gjeneralin Samardzic gjatë kohës që ai  
24 ishte në rangje drejtuese të ushtrisë jugosllave në vitin  
25 1998, po apo jo?

1 PË. Dikund në dhjetor të '98, janar të '99, pak a shumë rreth  
2 periudhës së vitit të ri kemi folur.

3 PY. Po flas gjatë gjithë kohës që ju keni qëndruar atje dhe  
4 në të njëjtën kohë ky gjeneral ishte ndër komandantët e  
5 forcave jugosllave në Prishtinë. Gjatë kësaj periudhe kohore  
6 ju keni folur me këtë gjeneral dhe i keni treguar se çfarë  
7 shihnit kur dilnit në terren, po apo jo?

8 PË. Ju thashë që e kam takuar në Nish rreth periudhës, rreth  
9 kohës së vitit të ri. Më pas nuk u takuam. E takova edhe një  
10 herë në ndërtesën e këshillit ekzekutiv. Kishte një aktivitet  
11 të madh atje dhe ishte udhëheqja politike, por kaq.

12 PY. Z. Radosevic, gjenerali Samardzic, kushëriri juaj, ishte  
13 oficer jugosllav që kishte përgjegjësi në Kosovë deri në fund  
14 të '98, gjatë gjithë kohës që po ndodhnin këto ngjarje, a  
15 është kjo e saktë?

16 PË. Por mundet që edhe në '99. Unë s'jam i sigurt deri në  
17 ç'vit e ka pasur këtë post. Por nuk ka rëndësi, po ka qenë  
18 atje, e vërtetë është kjo.

19 PY. Atë e zëvendësoi gjenerali Petkovic në fillim të '99.

20 PË. Petkovic, po, po.

21 PY. Kur ishte në pozicion drejtues, gjenerali, ju ishit  
22 reporter që udhëtonit në Kosovë gjatë vitit '96, '97, '98,  
23 kështu?

24 PË. Po, edhe?

25 PY. Unë po ju sugjeroj që gjatë kësaj kohe ju i raportoni



1 ushtrisë jugosllave. Çfarë shihnit ju si reporter i Tanjug-ut  
2 kur dilnit nëpër Kosovë, në terren. Kështu? Po apo jo? Po apo  
3 jo?

4 PË. Jo.

5 PY. Dëshmia juaj, pra, është që ju keni një kushëri të afërt  
6 në ushtrinë jugosllave që donte informata për UÇK-në dhe ju  
7 udhëtonit në gjithë Kosovën dhe ju ishit reporter i Tanjug-ut  
8 dhe ju nuk jepnit informacion të afërmit tuaj apo vartësve të  
9 tij gjatë kësaj periudhe kohore se çfarë shihnit ju nëpër  
10 Kosovë, kjo është dëshmia juaj?

11 PË. Po, kjo është. Për çfarë i duhej, pse duhet të merrte ai  
12 informacione prej meje?

13 PY. Këtë pyetje bëja vetes.

14 Ky përgjim i pretenduar që kinse ta ka thënë gjenerali  
15 Samardzic është një përgjim që ju vetë nuk e keni parë apo jo?

16 PË. Çfarë doni të thoni ju, "shihni"? E keni fjalën ta shihja  
17 me shkrim?

18 PY. Në çdo formë. A e keni parë me shkrim, a ju la ta  
19 dëgjonit, a ju tregoi ndonjë raport? Çdo gjë. A ju dha ndonjë  
20 copë letër që të verifikonte se përgjigja -- më lejoni të  
21 mbaroj.

22 PË. Jo, thjesht më tha që u vunë, dy gjëra u vunë re që ai  
23 kishte një informator në Shalë që shkonte në Prishtinë dhe se  
24 përmende thirrjen telefonike të z. Thaçi që ishte përgjuar.

25 Kaq ishte historia.

1 PY. Zotëri, a e kuptoni, pra, gjenerali Samardzic a ju ka  
2 thënë Samardzic, a ju ka thënë ndonjëherë kur ku ndodhur ky  
3 përgjim?

4 PË. Jo, konkretisht datën nuk ma ka thënë.

5 PY. A e dini ju që President Thaçi as nuk ka qenë në Kosovë  
6 në kohën kur jeni liruar ju dhe se ishte larguar nga Kosova në  
7 mes të nëntorit të '98? A e dini ju këtë?

8 PË. Jo, nuk e di. Unë po ju them çfarë më tha ai. Më tha që  
9 një thirrje telefonike është përgjuar. Tani se ku është bërë  
10 kjo thirrje unë nuk e di. Unë po ju përcjell çfarë më tha ky  
11 person.

12 PY. Pra, mund të themi që ju nuk e keni idenë se ku ishte  
13 President Thaçi ditën e lirimit tuaj, po apo jo?

14 PË. Absolutisht që jo. E kam thënë gjatë gjithë kohës, unë  
15 s'e njihja këtë zotëri.

16 PY. Pra, ju nuk e dini që lirimin tuaj e urdhëroi Adem  
17 Demaçi. Pra, Adem Demaçi urdhëroi Sokol Bashotën që t'ju  
18 lironte. As për këtë nuk keni dijeni?

19 PË. Po nuk e di pse, pse duhet ta dija unë këtë gjë? Pse  
20 duhet ta dija unë që Adem Demaçi ia ka thënë këtë Sokol  
21 Bashotës.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Më jepni një çast të konsultohem.

23 [Mbrojtja këshillohet]

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Dua të flasim për kontaktin me z. Thaçi. Më kujtuan,

1 zotëri, sa i takon kontaktit që keni pasur me z. Thaçi. Në  
2 intervistën tuaj në faqen 1488, pra, në provën materiale  
3 488.2, faqja 10, rreshti 18 deri në 20 ju thoni:

4 "Për Thaçin mësova vetëm kur u lirova se kishte një  
5 fletarrest për të. Hashim Thaçi njihej si "Gjarpri".

6 Pra, ju dëgjuat për Thaçin ose mësuat për Thaçin vetëm  
7 pasi doli ky fletarrest. A e kam kuptuar siç duhet radhën e  
8 ngjarjeve, kronologjinë?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, kjo është hera e parë që dëgjuat për Thaçin, kur  
11 doli fletarrest, kështu? A është e saktë?

12 PË. Po, po kjo është hera e parë që e dëgjova emrin e z.  
13 Thaçi.

14 PY. Dhe sipas jush kjo fletarrest ka dalë para bisedës që  
15 keni pasur me gjeneralin Samardzic në dhjetor ose në janar,  
16 pra, në dhjetor të '98 ose në janar të '99? Pra, para bisedës?

17 PË. Po s'e mbaj mend saktësisht se kur është lëshuar  
18 fletarrest.

19 PY. I keni thënë ZPS-së kështu: "E dëgjova për herë të parë  
20 emrin e Thaçit vetëm kur doli një fletarrest për të".

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Është reflektuar kjo në provën  
22 materiale 488.2, faqja 10, rreshtat 18 deri 20.

23 PY. Pra, këtë i keni thënë ZPS-së, hera e parë që keni  
24 dëgjuar për Thaçin është kur doli fletarrest.

25 PË. Po.

1 PY. A është e saktë?

2 PË. Po. Po kështu. Kështu është.

3 PY. Ju po dëshmoni se keni dëgjuar për fletarrestin përpara  
4 se të bënin këtë bisedën e pretenduar për një përgjim me  
5 kushëririn tuaj gjeneralin Samardzic?

6 Z. BOYLE: [Përkthim] E kundërshtoj. Disa herë është bërë  
7 pyetja dhe është marrë përgjigja.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.  
9 Përgjigjuni pyetjes.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë nuk po them, nuk e them dot me  
11 saktësi. Mund të ketë qenë më përpara, më pas. Nuk më kujtohet  
12 në qoftë se fletarresti u lëshua para apo pas kësaj bisede.  
13 Nuk e di çfarë rëndësi ka. Nuk më kujtohet data.

14 Unë nuk është se ulesha në shtëpi dhe shihja të gjitha  
15 datat. Unë kam ardhur këtu të them ato që di.

16 Z. KEHOE: [Përkthim]

17 PY. Faleminderit, por unë po ju sugjeroj këtë. Hera e parë që  
18 ka ndodhur kjo, hera e parë që keni përmendur bisedën me  
19 gjeneralin Samardzic ka qenë para katër ditësh. I keni thënë  
20 ZPS-së që hera e parë që keni dëgjuar për z. Thaçi ishte kur  
21 doli një fletarrest për të dhe unë po ju propozoj dhe po ju  
22 them që fletarresti për President Thaçi ka dalë në mars të  
23 1999, disa muaj pas bisedës suaj të pretenduar me gjeneralin  
24 Samardzic ku ai ju ka treguar për këtë kinse përgjim të  
25 bisedës mes Thaçit, të thirrjes telefonike me Thaçit dhe

1 Demaçit.

2 Unë besoj se ju e kuptoni sa e rëndësishme është  
3 kronologjia e kësaj ngjarje. E kuptoni, po apo jo?

4 PË. Po, e kuptoj. Po, e kuptoj.

5 PY. Pra, ju keni dëgjuar për Thaçin për herë të parë në mars  
6 të '99. Asnjëherë s'e keni bërë këtë bisedën që e nxorët tri a  
7 katër ditë më përpara me ZPS-në për këtë kinse bisedë që keni  
8 bërë ju me Samardzic në dhjetor të '98 apo në janar të '99, po  
9 apo jo?

10 PË. Mbase në janar. Në janar mund të ketë qenë. Ç'rëndësi ka.  
11 Po unë këtë po ju them.

12 Unë di vetëm çfarë më tha gjenerali Samardzic. Mbase për  
13 atë kohë President, z. Thaçi për mua nuk ishte ndonjë figurë e  
14 rëndësishme dhe unë ju thashë që për herë të parë, zyrtarisht,  
15 kam dëgjuar për të më vonë. Asokohe për mua Demaçi ishte  
16 figurë më e rëndësishme sesa personi që po diskutojmë tani. Z.  
17 Thaçin e dëgjova për herë të parë përmes fletarrestit. Mbase  
18 ka qenë në mars. Unë kisha menduar se mos është lëshuar më  
19 herët, por sinqerisht nuk më kujtohet se kur është lëshuar ky  
20 fletarrest.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë  
22 pushimin tani. Bëjmë gjysmë ore pushim. Dëshmitar, do të  
23 kthehemi në orën 11.30. Largohu bashkë me asistenten. Ajo do  
24 të shoqërojë jashtë sallës së gjyqit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Dua t'ju informoj që mund të kem  
2 edhe shumë pak pyetje. Mbase dhe nuk do të kem më pyetje, por  
3 për këtë do të vendos gjatë pushimit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca  
5 ndërpritet. Rimblidhemi, ritakohemi në orën 11.30.

6 --- Pauza fillon në orën 11.03

7 --- Seanca rifillon në orën 11.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni më?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, por në --  
10 për të mos e ngatërruar procesverbalin, për të mos e  
11 komplikuar --

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt e  
13 keni ngatërruar, nuk është se nuk e keni bërë këtë gjë deri  
14 tani.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirë, për të mos e ngatërruar më  
16 tej, kam shumë prova materiale, megjithatë ndërkohë që i  
17 shikoj dhe një herë provat materiale që duhet t'i tregoj  
18 dëshmitarit, shikoj që kemi të bëjmë me shumë materiale të  
19 tilla, si për shembull, konferenca për shtyp dhe doja që t'ju  
20 kërkoj leje, të nderuar Anëtarë të Trupit Gjykses, që të më  
21 jepni pak më shumë kohë, në mënyrë të tillë që të bëjmë  
22 propozimin e duhur për sa i takon materialeve që do të  
23 përgatisim dhe që do t'i paraqesim dëshmitarit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, në  
25 rregull, por ju lutem jini të kujdesshëm.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe (Vazhdim)

Faqe 63

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, në rregull, pa diskutim. Ju  
2 kërkoj ndjesë në qoftë se kam nxjerrë ndonjë informacion që  
3 nuk duhet ta nxjerr, megjithatë kjo është në frymën e  
4 kundërpyetjeve për dëshmitarin. Megjithatë, pavarësisht kësaj,  
5 besoj që do jeni të kënaqur që do dëgjoni që nuk kam pyetje të  
6 tjera për dëshmitarin, përveç pjesës së sqarimit të  
7 materialeve për Prokurorinë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. I  
9 lutem znj. Sekretare të sjellë dëshmitarin në sallën e gjyqit.  
10 Jemi në seancë publike.

11 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni pyetje?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam pyetje, thjesht do  
14 falënderoj dëshmitarin.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po mirë, le  
16 të vijë dëshmitari njëherë, pastaj falënderojeni.

17 [Dëshmitar vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
19 vazhdoni te -- Kehoe, fjala është për ju.

20 Z. KEHOE: [Përkthim]

21 PY. Faleminderit shumë, dëshmitar, që erdhët, dhatë dëshminë.  
22 Nuk kam pyetje të tjera për ju.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga Mbrojtja  
24 e z. Veseli?

25 Znj. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe ne nuk kemi pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, unë kam disa pyetje.

5 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

6 Z. ELLIS: [Përkthim]

7 PY. Mirëmengjes, dëshmitar. Unë jam përfaqësuesi i z.

8 Krasniqi, kam pak pyetje për ju. Kam përshtypjen që mund të

9 përfundojmë për 15-20 minuta, jo më shumë se kaq.

10 PË. Në rregull.

11 PY. Përpara pushimit, z. Dëshmitar, z. Kehoe ju lexoi një

12 fragment nga intervista e Prokurorisë lidhur me emrat e

13 personave që ju njihnit nga UÇK-ja. Aty thatë, përmendët juve,

14 që Jakup Krasniqi ishte komisioner politik. A ju kujtohet ta

15 keni thënë këtë gjë? Ndoshta pak para se sa të bënit pushimin

16 për kafe?

17 PË. Po, po. Në rregull.

18 PY. Ju personalisht nuk e keni takuar asnjëherë z. Krasniqi,

19 apo jo?

20 PË. Jo.

21 PY. Por ky ishte informacion i njohur publikisht, apo jo?

22 PË. Po. Është e saktë, është e saktë që nuk e kam takuar

23 ndonjëherë z. Krasniqi.

24 PY. E kuptova, Dëshmitar. Ishte informacion që dihej

25 publikisht që z. Krasniqi ishte zëdhënës i UÇK-së, apo jo



1 dëshmitar?

2 PË. Po, pak a shumë kështu, që ishte një komisar politik ose  
3 zëdhënës, pak i ngjashëm me z. Demaçi. Ndoshta njëri prej tyre  
4 ishte përfaqësuesi politik, tjetri zëdhënës, domethënë, pak a  
5 shumë po.

6 PY. Dhe, ai në deklaratat për shtyp prezantohej me emrin e  
7 vet të vërtetë, jo me nofkë, domethënë, si Jakup Krasniqi, jo  
8 me një nofkë, apo jo?

9 PË. Unë e njihja atë që si Jakup Krasniqi, nuk di në qoftë se  
10 ka pasur ndonjë nofkë apo jo.

11 PY. Dhe për këtë arsye juve përmendët emrin e tij siç e ka  
12 zotëria, kur folët për Prokurorinë, apo jo?

13 PË. Po, e njihja atë nga media. Asgjë më pak, asgjë më shumë  
14 se sa kaq. Thjesht dija që ekzistonte një zotëri që quhej  
15 Jakup Krasniqi që ishte zëdhënësi, siç e thatë edhe ju.

16 PY. E kuptoj, në rregull. Tani, duke folur për deklaratat për  
17 shtyp të asaj kohe. Ju si gazetar, e kuptoni apo jo, që jo çdo  
18 deklaratë e bërë nga një palë në konflikt është  
19 domosdoshmërisht e vërtetë? Është kështu apo jo?

20 PË. Po, sigurisht. Kështu duhet të jetë. Dhe ashtu është në  
21 fakt.

22 PY. Dhe në veçanti në atë kohë, deklaratat e UÇK-së kishin  
23 tendencë që ta zmadhonin nivelin e organizimit të UÇK-së, a  
24 është e vërtetë kjo?

25 PË. Besoj se po.

1 PY. Mënyra se si e keni formuluar përgjigjen kur jeni pyetur  
2 nga Prokurori dhe për ata që na ndjekin është prova materiale  
3 488.2 në faqen 18 -- ose 19, nëse s'e kam gabim. Aty ju thoni  
4 që:

5 "...kishin disa deklarata në media që mundoheshin që të  
6 tregonin që ekzistonte diçka, e që kishte një lloj Gjykate."

7 Pra, ajo që po mundoheni të thoni ju është që ka pasur  
8 ekzagjerim, ose zmadhim sa i takon nivelit të organizmit të  
9 UÇK-së, këtë keni dashur të thoni?

10 PË. Po, kështu është.

11 PY. Nuk dua që të thellohem shumë apo të flas me shumë  
12 hollësi lidhur me gjërat që ju thatë sot paradite, për sa i  
13 takon vendeve ku jeni ndaluar. Kemi dëgjuar me vëmendje  
14 gjithçka që keni thënë më herët.

15 Megjithatë, ajo çfarë thatë juve ishte që në përgjithësi  
16 trajtimi që ju kanë bërë ka qenë korrekt, apo jo?

17 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtim, ky është keqpërfaqësim  
18 i dëshmisë. Dëshmitari ishte shumë i qartë që ka pasur disa  
19 incidente gjatë ndalimit të tij.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase do  
21 ishte mirë që t'i bëni -- ta bëni më konkrete pyetjen, lidhur  
22 me kohën.

23 Z. ELLIS: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, ju thatë që kryesisht trajtimi ishte korrekt.  
25 Është e vërtetë kjo apo jo? Këto janë fjalët që përdorët ju.

1 PË. Po, për pjesën e dërrmuese, për pjesën dërrmuese ishte  
2 korrekt.

3 PY. Ju thatë që ju kanë dërguar në katër vende të ndryshme.  
4 Këtë thatë? I kam numëruar siç duhet vendet?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe në këto katër vende të ndryshme ju keni parë, jeni  
7 takuar me persona të ndryshëm. Pra, persona të ndryshëm kanë  
8 pasur kontakt, kanë pasur kontakt me juve, kështu i takon, apo  
9 jo?

10 PË. Po.

11 PY. Disa prej tyre kanë qenë persona të arsimuar që ju kanë  
12 trajtuar me kujdes, apo jo? Me mirësjellje, apo jo?

13 PË. Po, duke gjykuar me sa kam parë, po. Të thjeshtë, do  
14 thoja po, nuk jam unë personi për të vlerësuar në qoftë se ata  
15 ishin persona të arsimuar apo jo. Megjithatë, nga çfarë kam  
16 parë mund të arrija në përfundimin që po, disa prej tyre ishin  
17 më të edukuar. Sigurisht që ka pasur edhe persona të edukuar,  
18 pse jo.

19 PY. Pra, ca persona ju kanë trajtuar më mirë dhe ca të tjerë  
20 ju kanë trajtuar më pak mirë, kështu?

21 PË. Po, sigurisht.

22 PY. Për shembull, kur ju kanë ndaluar për herë të parë dhe  
23 kur ju kanë dërguar në Shalë, atje ju kanë dërguar dy vetë,  
24 apo jo?

25 PË. Ka pasur më shumë se sa dy. Kishte disa njerëz në secilën

1 prej automjeteve, por mund të themi që dy vetë na dërguan atje  
2 dhe dy të tjerë folën me neve, komunikuan me neve, kështu që  
3 është e saktë kjo që thatë.

4 PY. Nga këta dy personat që folën me juve, njëri prej tyre  
5 ishte i edukuar dhe ju bëri pyetje me shumë mirësjellje,  
6 ndërkohë që personi tjetër ishte arrogant dhe ju fyeu. Kështu  
7 ka ndodhur?

8 PË. Po. Tjetri nuk ishte i këndshëm. Kështu do e thoja unë.  
9 Besoj që kjo është mënyra më e mirë për ta përshkruar atë.

10 PY. Pra, persona të ndryshëm, duke marrë parasysh rrethanat e  
11 çështjes, rrethanat e rastit, silleshin në mënyrë -- janë  
12 sjellë në mënyrë të ndryshme me ju, apo jo?

13 PË. Po, kështu ishte.

14 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Mora dhe më pak kohë se sa  
15 mendoja se do të merrja.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje  
17 plotësuese.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,  
20 do na duhen rreth 10-15 minuta për të bërë pyetje plotësuese  
21 për dëshmitarin.

22 Pyetje vijuese nga z. Boyle:

23 Z. BOYLE: [Përkthim]

24 PY. Z. Radosevic, dua të filloj duke paraqitur në ekran një  
25 provë materiale që u tregua nga Mbrojtja.

1           Z. BOYLE: [Përkthim] Do t'i kërkoja Sekretares të  
2 paraqesë në ekran dokumentin DHT0267 [Sipas përkthimit]. Është  
3 një dokument me një faqe. Po ashtu ky është një dokument i  
4 cili u trajtua më herët. Është pasqyruar në transkript në  
5 faqen 29.

6           Z. KEHOE: [Përkthim] Më lejoni t'ju ndërpres, mbase do  
7 ishte më e thjeshtë, i nderuar Gjykatës, që ta pranoni në  
8 provë materiale, sepse dokumentet për të cilat po flasim duhen  
9 selektuar, duhen përzgjedhur disa, domethënë do ishte më mirë  
10 që ndoshta të pranohen në prova materiale që ta ketë më të  
11 lehtë Prokurori.

12           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkohen që  
13 të pranohen në prova materiale, keni ndonjë kundërshtim  
14 Prokuror?

15           Z. BOYLE: [Përkthim] Jo.

16           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
17 Dokumenti DHT02672 pranohet në provë materiale. I lutem  
18 Sekretares t'i japë një numër prove.

19           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës  
20 materiale 1D52.

21           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

22           Z. BOYLE: [Përkthim]  
23 PY. Na shpjeguat më herët gjatë ditës që disa prej rrugëve që  
24 përshkruat duke vozitur me makinë, nuk ishin të asfaltuara dhe  
25 që keni ndaluar për të bërë ca pushime të shkurtra disa herë.

1 Nëse do shikojmë dokumentin --

2 Z. BOYLE: [Përkthim] Nëse mund ta ngremë dokumentin në  
3 ekran, besoj që duhet të jetë diku nga fillimi i dokumentit.

4 PY. Dëshmitar, a e shikoni datën në krye të faqes, të hartës,  
5 në anën e majtë që dokumenti mban datën 7 tetor 2023? A e  
6 shihni datën?

7 PË. Po, po. E kemi përpara.

8 PY. A e dini në qoftë se rrugët në Kosovë në 1998 kanë qenë  
9 në të njëjtat kushte që janë rrugët sot, ose para disa ditësh  
10 kur është bërë kjo fotografia e hartës?

11 PË. Nuk e di. Nuk mund t'ju jap një përgjigje. Mbase ka  
12 ndryshuar gjërat gjatë 25 viteve të fundit, nuk di ç't'ju  
13 them.

14 PY. Periudha e kohës që vlerësuat kur po diskutonit, e kam  
15 fjalën që sa zgjati rrugëtimi nga njëra pikë te tjetra, a  
16 patët ndonjë aparat për të matur kohën? Domethënë kishit  
17 ndonjë orë, ose ndonjë gjë tjetër për të matur orën, ose është  
18 diçka që ju e mendoni thjesht që kaq ka zgjatur rrugëtimi?

19 PË. Jo. Nuk kisha orë, nuk është se pyeta njeri. Por thjesht  
20 aq e gjykova unë. Ashtu mendova unë, aq kohë kishte kaluar.

21 Ndoshta mund të kishte qenë një orë e gjysmë, dy. Pak a shumë  
22 aq kohë. Nuk është se udhëtuam as për gjysmë dite, as për 20  
23 minuta. Zgjati ca dhe sipas vlerësimit tim ka zgjatur rreth dy  
24 orë.

25 PY. Keni udhëtuar gjatë ditës apo gjatë natës?

1 PË. Në mbrëmje.

2 PY. A keni pasur mundësi që të shihnit ndërkohë që po ju  
3 vozisnin?

4 PË. Jo, na i kishin lidhur sytë. Dhe duart po ashtu i kishim  
5 të lidhura.

6 PY. Vozitja, rrugëtimi ishte i qetë apo ndodhi ndonjë gjë që  
7 ju shkaktoi ndonjë frikë gjatë dërgimit nga njëri vend tek  
8 tjetri?

9 PË. Ishte i qetë. Përveçse herë pas here ata ndalonin.  
10 Flisnin me dikë. Na shanin nga nëna. Dhe kishte disa kërcënime  
11 që bëheshin nga disa vetë. Kështu që kemi ndaluar disa herë  
12 gjatë rrugës, ata bashkëbisedonin me ndonjë person që ishte  
13 aty dhe na bërtisnin, jo individët që ishin me neve në makinë,  
14 por persona që ishin jashtë.

15 Z. BOYLE: [Përkthim] Lidhur me këtë dua që t'ju përmend  
16 deklaratën që është pranuar si provë materiale P488.2. Faqja  
17 2, rreshtat 4 deri në 10.

18 PY. Këtë keni thënë, Dëshmitar, në atë kohë. Pra që "kishte  
19 abuzim verbal, që kishte sharje, kur na lëvizën nga Shala dhe  
20 ku kishte anëtarë të UÇK-së që i binin makinës, që thonin  
21 donin të qëllonin, të na qëllonin neve, të na vrisnin, që të  
22 hidhnin në erë..."

23 A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po, po. Për të qenë i saktë, ata donin që të na hidhnin  
25 në erë me granatë. Po, sigurisht që na kanë fyer, na kanë

1 sharë, në dy-tre raste kur kemi ndaluar gjatë rrugës.

2 PY. Ju na thatë që ju kishin lidhur sytë. A e dini ju se  
3 çfarë rruge ka ndjekur makina nga Shala për të shkuar në pikën  
4 tjetër?

5 PË. Jo, nuk e di. Si mund ta dija? Nga mund ta merrja vesh? I  
6 kisha sytë e lidhur.

7 PY. A është e mundur që të mos keni marrë rrugën që tregohet  
8 në dokumentin që keni përpara?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj, është spekulim. Nuk  
10 mund t'i përgjigjet kësaj pyetjeje dëshmitari.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.  
12 Vazhdoni.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e kam idenë se çfarë rruge  
14 kemi bërë. Kjo është hera e parë që e shikoj këtë hartë. Nga  
15 ta dija unë se si shkohet nga Shala për në Kleçkë. Nuk e di si  
16 kemi shkuar atje, nuk e di. Mund t'i jap përgjigje pyetjes  
17 tuaj vetëm në qoftë se do t'i njihja rrugët që lidhin fshatra  
18 të ndryshëm në Kosovë, dhe nuk i njoh në fakt këto rrugë.

19 Z. BOYLE: [Përkthim]

20 PY. Ju thatë që keni ndaluar rrugës nga pika A në pikën B.  
21 Keni ndaluar një herë, dy herë, ose mund ta thoni sa herë keni  
22 ndaluar pak a shumë?

23 PË. Dy ose tre herë. Më shumë se sa një herë, është e sigurt  
24 që më shumë se sa një herë. Dy ose tre herë.

25 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit, nuk më nevojitet më



1 dokumenti, mund ta hiqni nga ekrani, znj. Sekretare.  
2 PY. Z. Radosevic, ju thatë dje -- ose ju tregua nga Avokati  
3 pretendime të ndryshme nga z. Dobricic për sa i takon  
4 përfshirjes në luftime dhe furnizime me armë në vitet 1990  
5 jashtë Kosovës. Keni dëshmuar si në dëshminë tuaj dhe në  
6 deklarata që keni dhënë, për temat për të cilat ju jeni pyetur  
7 në Shalë, dhe që keni thënë që kjo është hera e parë për të  
8 cilën juve ju janë bërë pyetje.

9 Dhe për procesverbal, ju thatë që për pretendimet që u  
10 parashtruan nga Avokati ju nuk keni asnjë lloj dijenie. Po nga  
11 UÇK-ja, kur ju kanë bërë pyetje UÇK-ja, a ju janë bërë këto  
12 pretendime apo jo?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtojmë, të nderuar Gjykatës,  
14 çfarë vlere ka kjo pyetje në qoftë se UÇK-ja i ka bërë pyetje  
15 në qoftë se ai ishte spiun apo jo? Prokuroria duhet që ta  
16 vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm që këto dy persona  
17 ishin civilë, ishin persona civilë dhe nuk ishin luftëtarë,  
18 ose spiunë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

20 Z. BOYLE: [Përkthim]

21 PY. A ju është bërë ndonjë pyetje në Shalë kur ju kanë pyetur  
22 ata të UÇK-së, lidhur me z. Dobricic që mund të ishte i  
23 përfshirë në luftime, ose në furnizimin me armë në zona jashtë  
24 Kosove në fillim të viteve 1990?

25 PË. Le ta them kështu, sepse këtë e kanë diskutuar ata

1 ndërkohë dhe kam dëgjuar bisedën, por ndoshta do ishte mirë që  
2 ta përsërisni edhe një herë pyetjen.

3 PY. Po. Ju na thatë që ju -- jeni marrë në pyetje vetëm një  
4 herë në Shalë, dhe juve ju bënë pyetje për disa prej temave  
5 për të cilat ju është bërë pyetja.

6 Pyetja që kam për juve është kjo: kur ju kanë marrë në  
7 pyetje UÇK-ja, a ju kanë bërë pyetje pjesëtarët e UÇK-së sa i  
8 takon pyetjeve që bëri Mbrojtja e z. Thaçi për përfshirjen e  
9 z. Dobricic më herët në luftime ose në furnizime me armë, dhe  
10 juve thatë që nuk dinit ndonjë gjë konkretisht lidhur me këto  
11 pretendime?

12 PË. Jo, nuk di asgjë, dhe UÇK-ja nuk më bëri pyetje lidhur me  
13 këto pretendime.

14 PY. Kur biseduat më vonë me z. Dobricic sa i takon marrjes në  
15 pyetje dhe që UÇK-ja e kishte marrë atë në pyetje, a ju  
16 përmendi ai ju që UÇK-ja i kishte bërë pyetje atij lidhur me  
17 këto tema?

18 PË. Sigurisht jo, ai nuk më ka thënë asgjë lidhur me këtë.  
19 Dhe mendoj se e kam thënë një milion herë këtu se çfarë u  
20 diskutua që u diskutua për politikën, për Milosheviçin dhe  
21 kaq, kaq më ka thënë ai mua. Se çfarë ka diskutuar ai  
22 faktikisht me ta, unë këtë nuk e di, ai më ka thënë këto  
23 gjëra. Dhe sigurisht që unë nuk i kam pyetur pjesëtarët e UÇK-  
24 së se çfarë pyetje i kanë bërë atij.

25 Kështu që për ta përmbledhur, më lejoni të them që nuk më

1 ka thënë absolutisht asgjë lidhur me këtë temë.

2 PY. A ke pasur mundësi që të trajtonit ndonjë pretendim të  
3 kësaj natyre që kishin të bënin me z. Dobricic, qoftë përpara  
4 një gjykate ose një gjykatësi, lidhur me ndalimin tuaj apo me  
5 dënimin tuaj?

6 PË. E thashë, e thashë edhe më herët. Jam marrë vetëm një  
7 herë nga pyetja nga policia më datë 28 nëntor. Kolegët tuaj më  
8 intervistuan, nuk e di avokatët apo kolegët tuaj, në 2011,  
9 2012, dhe kësaj radhe kur jemi takuar. Askush nuk ma ka  
10 përmendur asnjëherë atë çfarë më parashtroi z. Kehoe, në qoftë  
11 se e kuptova siç duhet, dhe emrin e z. Kehoe. Askush nuk më ka  
12 pyetur mua lidhur me ngjarjet që lidhen me këtë gjë, ose me  
13 këtë person, me kolegun tim.

14 Është hera e parë që e dëgjoj këtë histori dhe dokumentin  
15 që lidhet me të. Nga do ta merrja vesh unë çfarë pyetjesh i  
16 kanë bërë atij lidhur me këtë fakt? Nga ta merrja vesh unë?  
17 Ata më pyetën çfarë ndodhi, unë thjesht i thashë që kolegu  
18 ishte bashkë me mua, dhe kaq, nuk di gjë tjetër.

19 PY. Dëshiroj tani të kalojmë në një temë pak sa të ndryshme.

20 Z. BOYLE: [Përkthim] Do t'i kërkoja Sekretares të  
21 paraqesë në ekran provën P494, është artikulli i Vice. Në  
22 faqen 5 në versionin anglisht, dhe besoj që në gjuhën serbe  
23 është faqja 7.

24 PY. Z. Radosevic, besoj që e kujtoni që më herët sot, ju  
25 bëhet një pyetje lidhur me deklaratën që ka të bëjë me

1 pretendimin tuaj që nuk është ushtruar dhunë fizike mbi ju. A  
2 ju kujtohet t'ju jetë bërë më herët kjo pyetje?

3 PË. Në rregull.

4 PY. A shihni pak më poshtë në këtë faqe, ku ju përshkruani si  
5 më poshtë, e citoj:

6 "Ditën e katërt, një grup prej katër ose pesë vetave  
7 erdhën, vërshuan, mësynë aty. Nuk i njoha ata se nuk i kisha  
8 syzet, por komandanti erdhi në dhomë dhe bërtiti dhe më shtiu  
9 armën në gojë, dh e më drejtoi gjithashtu armën në sy...

10 "Është -- nuk mjafton të thuash që situata ishte e  
11 pakëndshme, është shumë pak për ta thënë këtë gjë.

12 PËRKTHYESI: Shënimi i përkthyesve: Ju lutem, flisni pak  
13 më ngadalë se nuk e kemi tekstin në serbisht.

14 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Mendoj që faqja  
15 është e saktë në gjuhën serbe, është faqja 7.

16 Nuk e di në qoftë se mund të vazhdoj më tej.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
18 vazhdoni, por fakti që nuk e kanë faqen, përkthyesit, duhet që  
19 të lexosh ngadalë.

20 Z. BOYLE: [Përkthim]

21 PY. [Nuk ka përkthim]

22 PË. Ju kuptova, Prokuror. Dhe këtë ia thashë dhe më herët,  
23 është e vërtetë. Ai u mësy, u fut furishëm në dhomë, më fundi  
24 tytën e armës së vet në gojë, dhe më bëri që të bërtas UÇK,  
25 UÇK, më shtyu në kraharor, e gjithë kjo është ajo ça ka

1 ndodhur.

2 PY. Së fundi, dua t'ju pyes për diçka tjetër. Më herët sot ju  
3 bënë pyetje lidhur me deklaratën e z. Dobricic në videon që  
4 pamë kur ju të dy u liruat, ai ka thënë që në pjesën dërrmuese  
5 trajtimi ka qenë i mirë, ka qenë në rregull. Dhe që nuk kishte  
6 parë ndonjë person të ndaluar.

7 Dëshiroj t'ju bëj një pyetje lidhur me gjendjen tuaj  
8 mendore në atë kohë. Në atë çast a mendonit ju që ju mund të  
9 ishit kritikë lidhur me sjelljen e UÇK-së? A ishte moment ai  
10 për të qenë kritikë ju me UÇK-në? Si e ndienit ju situatën?

11 PË. A mund të ma sqaroni pak? Ju lutem, çfarë doni të thoni  
12 me "sjellje kritike", çfarë doni të thoni? A mund të ma  
13 sqaroni pak pyetjen?

14 PY. A mendoni që ishit i lirë, a ndiheshit i lirë që të  
15 flisnit haptazi për abuzimin që kishit pësuar në kohën kur  
16 ishit të ndaluar, domethënë kur u liruat a mendonit apo  
17 besonit që ishit të lirë që të flisnit për abuzimet që kishit  
18 pësuar?

19 PË. Prandaj thamë ne që trajtimi ishte korrekt, ishte në  
20 rregull për pjesën më të madhe. Mund të ketë pasë ndonjë gjë  
21 të vogël, por e lamë me kaq, se nuk dëshironim që t'i jepnim  
22 më shumë hollësi. Dhe deri herën e parë kur kolegu juaj erdhi  
23 që të më bënte pyetje, dhe deri atëherë as nuk më ka shkuar  
24 ndër mend që të them që dikush më ka abuzuar në këtë mënyrë  
25 ose në atë mënyrë. Unë nuk e dija se çfarë ndodhte në

1 Prishtinë, nuk e dija në qoftë se kishte luftime apo jo.  
2 Ndërkohë që isha i ndaluar. Kështu që nuk ishte në interesin  
3 tim që të thoja që më rrahën apo më futën tytën e pushkës në  
4 gojë, e të tjerë, e të tjerë. Kjo është arsyeja që pse thashë.  
5 Unë e di çfarë kam thënë në konferencën për shtyp. E kam  
6 thënë, për pjesën dërrmuese situata ka qenë në rregull. Ka  
7 pasur ca incidente të vogla, por në rregull. Domethënë, frikë  
8 ose pa frikë sigurisht që unë nuk isha i çmendur që të  
9 ekspozohesha në atë mënyrë në sekondën e parë mbasi u lirova.  
10 Menjëherë pas lirimit nuk mund të thoja këtë gjë. Sigurisht që  
11 kisha frikë, dhe sigurisht që nuk doja që të flisja publikisht  
12 lidhur me këtë. Dhe nuk e shikoja këtë si problem. Nuk e di në  
13 qoftë se e kuptova siç duhet pyetjen tuaj, dhe nuk e di në  
14 qoftë se ju dhashë shpjegimet e nevojshme.

15 PY. Në fakt po, e kuptuat drejt pyetjen time, dhe nuk kam  
16 pyetje të tjera për juve. Kaq pyetje kisha për ju dëshmitar.

17 PË. [Nuk ka përkthim]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kehoe?

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Kam edhe unë disa pyetje. Pyetje që  
20 kanë të bëjnë me pyetjet e fundit të Prokurorit.

21 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

22 Z. KEHOE: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, ju thatë që vutë re që nuk keni përmendur  
24 asgjë lidhur me aktivitetet e Dobricic kur ju pyeta unë gjatë  
25 ditës së djeshme dhe të sotme. Megjithatë, kur keni rishikuar

1 nga fjala hyrëse e Mbrojtjes së Thaçit keni vënë re që ka  
2 patur informacion lidhur mbi aktivitetin e Dobricic në Kroaci  
3 dhe në Serbi, apo jo?

4 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj, kjo nuk është -- nuk ka  
5 bazë në këtë të dhënë. Nuk është thënë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Miratohet.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Në fakt, ju ka dërguar një foto  
8 ekran të ZPS-së që vjen pikërisht nga kjo fjalë hyrëse. A nuk  
9 është kështu?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk ke  
11 marrë përgjigje për këtë.

12 A keni marrë ju një foto ekрани të fjalës hyrëse?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Atë e ka dërguar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, por në  
15 qoftë se nuk e ka marrë nuk ka si të japë përgjigje.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Më vjen keq që ai ka marrë pikërisht  
17 këtë foto ekran, ja ka dërguar atyre. Ja ka dërguar ZPS-së.  
18 ZPS-ja.

19 Z. BOYLE: [Përkthim] Ndoshta mund ta vendosni këtë ekran.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Po ju e keni këtë dokument.

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Po duhet për të gjithë. Për të  
22 gjithë, ka mundësi që ta vendosim në ekran me qëllim që t'u  
23 shërbejmë të gjithëve.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, dakord, e vendosim në ekran. Ka  
25 numër 211248 [sipas përkthimit] deri në 112750.

1 PY. Në fakt ju i keni dërguar një foto ekran zyrës së ZPS-së  
2 apo jo?

3 PË. Nuk shoh këtu asgjë. W03880, nuk di se çfarë është kjo  
4 gjë.

5 PY. Të kalojmë në faqen e parë, ju lutem. A nuk është kjo  
6 fotoja e ekranit që i keni dërguar ZPS-së?

7 PË. Një çast ju lutem.

8 PY. Dhe këtë është në shifrën 112749.

9 PË. Dakord.

10 PY. Ju dërguat këtë foto ekрани, foto ekрани nga fjala hyrëse  
11 e Mbrojtjes së Thaçit dhe ia dërguat këtë ZPS-së përpara  
12 dhënies së dëshmisë suaj. Pra ju keni pasur dijeni që Mbrojtja  
13 e presidentit Thaçi ka patur informacion të mëparshëm lidhur  
14 me aktivitetet ushtarake dhe kriminale të Dobricic në Kroaci  
15 dhe në Bosnjë e Hercegovinë, e keni patur këtë dijeni apo jo?

16 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju kundërshtojmë pasi kjo është në  
17 kundërshtim me provat e dhëna. Kjo foto ekran nuk paraqet atë.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, por unë kam bërë  
19 pyetje mbi atë që ai di apo jo?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A kanë gjë  
21 këto foto ekran që përfaqësojnë ato që thoni ju?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Atë që po them unë është që ai po i  
23 -- këtu bëhet fjalë për ndalimin e dy gazetarëve serbë dhe në  
24 diskutimet e tona [Nuk ka përkthim].

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Kur?



1 Z. KEHOE: [Përkthim] Dëshmitari e ka ditur që Mbrojtja e  
2 Thaçit ka patur informacion lidhur me aktivitetin e Dobricic.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyesni --

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të vini këtu për të dhënë  
5 dëshmi, ju keni patur dijeni që Mbrojtja e Thaçit ka patur  
6 informacion lidhur me aktivitete kriminale të Dobricic në  
7 Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kroaci, apo jo?

8 PË. Të fillojmë nga fillimi. Unë, shiko, çfarë u thashë atyre  
9 dhe e kam shpjeguar, të nderuar Gjykatës, një herë. Dhe ju  
10 thatë që unë e kam shpjeguar. Nuk është përmendur në këtë  
11 raport, përmendet z. Dobricic këtu? Ne të dy u përmendëm gjatë  
12 një emisioni diskutimesh në radio televizionin e Serbisë.

13 Dhe unë e dërgova aty për të dhënë që ju nuk kishit  
14 dijeni që aktakuza është publike. Ju po thoni tani që unë po e  
15 ndiqja këtë akuzë. Unë nuk kisha ide fare, as nuk e kam  
16 ndjekur as nuk e kam dëgjuar fjalën hyrëse. Dhe as nuk kam  
17 treguar ndonjë vëmendje lidhur me atë që përmban aktakuza. Kaq  
18 di me këtë.

19 Ia dërgova këtë pasi i pyeta, i thashë "A e dini që kjo  
20 është publike?", nuk kisha ide që ishte publike deri në këtë  
21 masë. E ç' rëndësi ka në fakt, si mund të thoni që Dobricic apo  
22 dikush tjetër? A e shihni se çfarë kam dërguar? Ju tani po  
23 pretendoni që unë isha duke lexuar -- duke dëgjuar palën  
24 Mbrojtëse? Jo në fakt nuk e kam dëgjuar.

25 PY. Ju e keni patur këtë emision natën e -- që në atë darkën

1 e fjalës hyrëse, apo jo?

2 PË. Nuk e kam shikuar këtë emision, një nga kolegët ma ka  
3 dërguar. Dhe më tha, "Shiko se çfarë përmbahet, çfarë ka  
4 këtu". Unë nuk e kam parë dhe s'kisha ide se për çfarë bëhej  
5 fjalë, nuk e di as çfarë dite ka qenë në fakt. Në fakt. Po i  
6 kthehem të njëjtës çështje gjithë kohën.

7 PY. I thatë ZPS-së që kur u liruat nuk ishit i lirë që të  
8 kritikoni apo të flisni lirisht lidhur mbi ato që ju kanë  
9 ndodhur gjatë kohës që ju kanë mbajtur të ndaluar, por ishit i  
10 lirë të bisedoni me ambasadorin Walker, apo jo?

11 PË. E thashë një herë, e thashë se çfarë kam diskutuar me z.  
12 Walker në makinë. Më pas thashë edhe se arriti familja ime dhe  
13 ne ishim rreth njëzet vetë dhe ishim si të thuash të ftuarit e  
14 tij. Unë kisha nevojë për cigare. Ai m'i dha. Pastaj më dha  
15 Coca-Cola, kërkova qumësht dhe më dha qumështin. Ndërkohë që  
16 po bisedonim, të gjithë ishim të lumtur në atë kohë duke  
17 biseduar.

18 Pastaj shkuam në një konferencë për shtyp dhe thashë atë  
19 që thashë. Thashë që në shumë, në pjesën më të madhe, trajtimi  
20 ka qenë korrekt. Dhe kam shpjeguar se përse.

21 PY. Dëshmitar, më lejoni t'ju lexoj se çfarë ka thënë  
22 ambasadori Walker në paragrafin 19:

23 "Gazetarët u liruan, erdhën në makinën time të blinduar  
24 në Prishtinë dhe kur këta u larguan nga kamerat dhe nga UÇK-  
25 ja, i pyeta edhe një herë se ç'kishin përjetuar dhe të dy

1 konfirmuan se nuk ishin keqtrajtuar.”

2 Pra tani kur ishit larguar nga kamerat dhe nga UÇK-ja dhe  
3 në praninë e ambasadorit Walker, dhe i sigurt, në fakt ju i  
4 thatë atij që nuk ju kishin keqtrajtuar. A nuk është kështu,  
5 po apo jo?

6 PË. Nuk jam i sigurt që ato kanë qenë fjalët e mia, fjalët e  
7 mia, kam dyshime, nuk kam ide. Në qoftë se kam thënë ndonjë  
8 gjë, është pikërisht ajo që kam thënë gjatë gjithë kohës këtu,  
9 dhe gjithandej. Nuk e di nëse ai ka folur me Dobricic, nuk e  
10 di, por nuk më kujtohet që unë të kem thënë këto fjalë.

11 PY. Në fakt, e tha që të dy kanë konfirmuar që nuk ishin  
12 keqtrajtuar.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Ka disa pyetje tani që vijnë nga ana e Gjykatësve.

16 Fillojmë me Gjykatësin Mettraux.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Paska pyetje të tjera, aha.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
19 Smith.

20 Pyetje nga Trupi Gjykses:

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

22 Kërkoj ndjesë që do t'ju bëjmë dhe disa pyetje. Ne gati po  
23 përfundam.

24 Dua t'ju pyes lidhur me vendet ku ju kanë mbajtur gjatë  
25 kohës së ndalimit. Dua ta shikojmë kronologjinë. Dhe kërkoj

1 ndjesë, pasi do t'ju kërkoj që të përsërisni disa nga  
2 hollësitë që ka gjasa që t'i keni dhënë tashmë. Megjithatë, po  
3 përpiqem që ta ndjek situatën hap pas hapi.

4 A kam të drejtë kur them që jeni larguar nga Prishtina më  
5 datën 18 nëntor 1998? A është e saktë?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a e dini se ç'ditë e  
8 javës ka qenë ajo, cila ditë e javës?

9 PË. Jo, e di se dita pasuese ka qenë ditëlindja e gruas sime  
10 dhe prandaj u largova nga Prishtina. Mund të ketë qenë e  
11 premte, ose e shtunë, ose e shtunë apo e diel. Por nuk jam i  
12 sigurt.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A të kujtohet afërisht ora  
14 kur je larguar nga Prishtina atë ditë?

15 PË. Besoj se ishte rreth orës 11.30 apo 12.00. Ndoshta  
16 12.30 apo 13.00.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nëse e kam kuptuar në  
18 dëshminë tuaj, ju ishit duke i dhënë makinës apo Dobricic i  
19 jepte një makine, Yugo e modelit Florida.

20 PË. Po, unë nuk di ta ngas makinën.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A të kujtohet nëse makina  
22 që përmendni ju ka patur targat nga Beogradi?

23 PË. Po, ishin targa të Beogradit, të bardha.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju po ecnit në makinë nga  
25 Prishtina në drejtim të fshatit të Magurës, kështu është?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju kaluat përmes  
3 aeroportit të Prishtinës në drejtim të Magurës, u kthyet në të  
4 djathtë, në drejtim të fshatit Sedllarë, apo Shalë, kështu  
5 është?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe përpara se të arrinit  
8 në Shalë, shpjeguat tashmë që ju arrestoi një grup pjesëtarësh  
9 të UÇK-së. Nuk do të flas në hollësi për këtë, por a të  
10 kujtohet emri i zonës apo i vendit ku ka ndodhur një gjë e  
11 tillë? Dhe unë e kam fjalën për vendin ku ju kanë ndaluar një  
12 grup ushtarësh të UÇK-së.

13 PË. Nuk ishte një vend, ishte në anë të rrugës. Nuk kishte  
14 qytet aty, nuk kishte asgjë përreth.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Emri Risinovc apo Rusinovc  
16 a ka ndonjë kuptim për ty?

17 PË. Jo, jo fare. Nuk e di. Nuk e di.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nga ai vend, me sa e  
19 kuptoj unë, ju kanë dërguar në një vend në Sedllarë, në Shalë,  
20 kështu është? UÇK-ja e ka bërë këtë?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa anëtarë të UÇK-së ju  
23 kanë shoqëruar nga vendi ku ju ndaluan ty dhe z. Dobricic deri  
24 në vendin ku ju kanë mbajtur të ndaluar? Sa anëtarë të UÇK-së  
25 ju kanë shoqëruar deri në atë vend?

1 PË. Dy deri në tre. Ishin dy makina, makina jonë dhe një  
2 makinë tjetër. Unë isha në një makinë, Dobricic-in e futën në  
3 makinën tjetër, kështu që do ketë patur tre, katër, deri në  
4 pesë persona.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe thatë që në atë vend  
6 keni qëndruar afërsisht, në atë vend në Shalë, keni qëndruar  
7 afërsisht 20 ditë, kështu është?

8 PË. Po. 19, 20, apo 21 ditë. Le ta përmbledhim të themi 20.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në ditën që ju mendoni  
10 që ishte dita e pestë e ndalimit tuaj në atë vend, filloi  
11 marrja juaj në pyetje. A kam kohën të saktë që kjo ndodhi para  
12 katër, pesë ditësh [sipas përkthimit] pas ndalimit tuaj?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe me sa e kam kuptuar  
15 unë, juve -- ka patur dy incidente që kanë ndodhur në atë  
16 datë. Po i përmbledh dhe ju lutem të më konfirmoni nëse e kam  
17 kuptuar saktë.

18 Pra ishte një incident i parë që ndodhi rreth orës 13.00,  
19 ku një individ erdhi, hyri në dhomën tuaj dhe ju kërcënoi me  
20 armën e tij duke e futur në gojën tuaj dhe duke -- dhe në sy.  
21 Dhe incidenti i dytë me katër individë të cilët kanë hyrë në  
22 dhomën tuaj dhe ju kanë marrë në pyetje. A e kam kuptuar drejt  
23 kronologjinë?

24 PË. Po. Por, herën e dytë nuk do ta quaja incident. Ishte  
25 thjesht njerëz që erdhën për të na marrë në pyetje.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sa kohë kaloi që nga  
2 incidenti i parë e deri te marrja në pyetje nga këto katër  
3 persona? Ishte çështje minutash, orësh? Sa kohë ka kaluar mes  
4 të dy ngjarjeve?

5 PË. 10, 15 minuta maksimumi. Pak a shumë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe tani dua të bëj disa  
7 hollësi lidhur me atë që keni thënë lidhur me këtë incident.

8 Dhe kjo është prova materiale P489. Për procesverbal  
9 është SPOE00078810. Në faqen 6 të këtij dokumenti,  
10 SPOE00078815.

11 Po lexoj shkurtimisht atë që keni thënë dhe do t'ju bëj  
12 disa pyetje pasuese. Aty fillohet me fjalën:

13 "Ditën e pestë apo të gjashtë..."

14 A e shikon këtë pjesë?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në anglisht thuhet:

17 "Në ditën e pestë apo të gjashtë filloi marrja në pyetje.  
18 Rreth orës 13.00 një burrë hyri në dhomën time. Nuk e njihja.  
19 Ishte veshur me një uniformë lara-lara. Ishte i rruar, i ri,  
20 filloi të bërtiste dhe ma vuri armën e tij automatike në gojë.  
21 Pushka nuk ishte kallashnikov, por ishte një pushkë  
22 automatike. Ai më tregoi emblemën e UÇK-së dhe më pyeti nëse e  
23 dija se çfarë ishte. U përgjigja ashtu sa munda të  
24 përgjigjesha duke patur parasysh që kisha tytën e pushkës në  
25 gojë dhe thashë që ishte emblema e UÇK-së. Ai më kërkoi që të

1 përgjigjesha në gjuhën shqipe, dhe unë thashë që ishte UÇK në  
2 shqip. Dhe më pas ai më drejtoi armën në sy. Më pyeti se përse  
3 nuk e flisja rrjedhshëm gjuhën shqipe. I thashë që unë flas  
4 pak shqip. U largua nga dhoma duke qeshur.”

5 A është kjo një përmbledhje e saktë e incidentit të parë?  
6 PË. Po. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe më pas thuhet:

8 “Më pas kanë hyrë në dhomë katër persona. Njëri nga të  
9 cilët ishte rreth 25-26 vjeç. Ai kishte veshur një uniformë  
10 lara-lara të hekurosur, të pastër, nuk kishte armë dhe dukej  
11 si një përfaqësues politik. Tjetri ishte edhe më i ri, ai  
12 ishte vendas, dhe i veshur me rroba civile.”

13 Edhe një herë, a e është kjo një përshkrim i saktë i asaj  
14 që ju kujtohet lidhur me personat që kanë hyrë në dhomë për  
15 t’ju marrë në pyetje?

16 PË. Po, çdo gjë që shkruhet këtu është e saktë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe s’ka nevojë që t’ju  
18 tregoj, por në intervistën tuaj të vitit 2012, P490, në faqen  
19 4, ju keni përshkruar individin e parë, 25-26 vjeçar, në  
20 këtë mënyrë:

21 “Ai kishte një uniformë lara-lara të pastër. Nuk kishte  
22 armë dhe dukej si përfaqësues politik. E them këtë pasi ishte  
23 e qartë nga pamja e tij dhe mënyra e të folurit që ishte  
24 person i arsimuar dhe nuk ishte ushtar i thjeshtë. Ishte lloji  
25 i njeriut që të ishte përfaqësues politik, apo student.”



1 A ju kujtohet saktë edhe sot se kështu e keni kujtuar  
2 paraqitjen e atij personi?

3 PË. Po. E kam përmendur nja dy herë që dukej si student, si  
4 një person i arsimuar, i shkolluar, i kulturuar. Ai kishte  
5 këtë uniformë, nuk kishte armë me vete. Ky ishte personi që më  
6 ka marrë në pyetje.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a është e saktë që në  
8 atë moment ty t'i kishin marrë syzet, apo jo?

9 PË. Po, po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Para pak çastesh i thatë  
11 Prokurorit që kjo ju ka bërë të -- vështirësuar mundësinë që  
12 t'i shihnit njerëzit apo jo? Dhe njihnit?

13 PË. Po, po, unë e thashë gjithashtu që nuk e kam vëzhguar atë  
14 më nga afër, me përjashtim të këtij personi, studenti që them  
15 unë, që sillej në mënyrë të civilizuar, të qytetëruar, nga  
16 mënyra e të folurit.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sa kohë mendoni se  
18 keni biseduar me këta individë?

19 PË. 40, 45 minuta, 30 minuta.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ndërkohë që ndodhte  
21 një gjë e tillë, a e keni shikuar në sy apo keni shmangur  
22 shikimin?

23 PË. Varet. Me këtë person kam patur një bisedë normale.  
24 Personi tjetër që kam përmendur më vonë, dhe ai më ka shikuar.  
25 Dhe dy të tjerët, i njihja pasi i kisha parë edhe më herët. Me

1 gjithë këtë me këtë person kam patur një bisedë krejtësisht  
2 normale.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dakord. Në deklaratën  
4 tuaj, që është P489, thuhet aty që:

5 "Individi i tretë që erdhi në dhomë në atë kohë ishte më  
6 i vjetër, rreth 45 vjeç, dhe më dukej sikur ishte plot  
7 autoritet. Ai kishte edhe flokë, edhe mustaqe të thinjura. Ai  
8 vëzhgonte, personi i katër nuk e përshkruaj dot, nuk ishte i  
9 rëndësishëm, ishte -- thjesht vëzhgonte. Marrja në pyetje ka  
10 zgjatur rreth 40, 45 minuta dhe ishte diskutim i aspekteve  
11 politike në përgjithësi."

12 Pyetja ime është: Në çfarë gjuhe keni komunikuar me këtë  
13 individ?

14 PË. Serbisht.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a të kujtohet se kush  
16 ka qenë ky person që ka biseduar me ty në serbisht, apo ishin  
17 të katër që flisnin serbisht, apo ishte vetëm njëri? Apo ishte  
18 një që përkthente e kështu me radhë?

19 PË. Ky djaloshi i ri 25-26 vjeçar, ai ka folur. Dhe ai ka  
20 folur në serbisht. Personi me flokët e thinjur, edhe ai më  
21 është drejtuar në serbisht. Megjithëse me atë kam shkëmbyer  
